



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 491 Akti

Nr. 488 Vendimi
Tiranë, më 15.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 13.12.2021, ora 10:00 dhe në datën 15.12.2021, ora 9:30 në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Tereza Merkaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Tereza Merkaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni). Për shkak të kandidimit¹ të saj pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rivlerësimi i saj u krye me përparësi.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Tereza Merkaj, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, të trupit gjyqësor, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Tereza Merkaj, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjyqësor, komisioneren Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjyqësor deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Në datën 22.7.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjyqësor, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datë 9.9.2020, deklaroi përmes postës elektronike në materialin “përgjigje të shtjelluara të pyetësorit standard”, mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjyqësor.
6. Në datën 2.12.2021, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Tereza Merkaj, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 2.12.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i

¹Sipas shkresës nr*** prot., datë 6.5.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

rivlerësimit dërgoi në mënyrë zyrtare, shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 9.12.2021, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Tereza Merkaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin, me anë të postës elektronike, se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 13.12.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Tereza Merkaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe për procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues në mbledhjen e zhvilluar pas seancës dëgjimore në datën 13.12.2021, në diskutimet për çështjen e subjektit Tereza Merkaj, në lidhje me konstatimin e dy transaksioneve bankare të kryera nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2002, kohë kur ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës, për një hetim të plotë, shterues dhe gjithëpërfshirës me vendimin nr. 4, datë 13.12.2021, vendosi të riçelë hetimin administrativ dhe t'i kërkojë subjektit shpjegime për këto veprime bankare, si dhe dokumentacionin provues, procedurë dhe kërkim, i cili iu njoftua subjektit po në këtë datë, në rrugë elektronike.

11. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, me vendimin nr. 5, datë 14.12.2021, vendosi mbylljen e hetimit administrativ dhe njoftimin e subjektit² për vijimin e seancës dëgjimore në datën 15.12.2021, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Tereza Merkaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 15.12.2021, për të rifilluar në të njëjtën datë, ora 12:00, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Tereza Merkaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe kreun IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin, në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja, është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr.

²Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike, në datën 14.12.2021.

2/2017 të Gjykatës Kushtetuese³ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 20.3.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Tereza Merkaj, e cila është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2004, me nr. *** indeksi dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2004 – 2016 dhe në datën 23.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë e në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e/të administruara nga korrespondenca e mbajtur me organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaramet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (dh) argumentimet e dhëna me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 23.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Pasuri e paluajtshme, apartament 1+1, me sip. 57.40 m² (e rivlerësuar), me nr. pasurie *, Z.K. ***, rruga “***”, ap. ***, Tiranë.**

Ky apartament është blerë i mobiluar me kontratë noteriale të shitblerjes nr. ***, datë 1.12.2004, në vlerën 5.000.000 lekë. Burim i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer kredia (shihni të dhënat konfidenciale) në vlerën 32.000 euro, në NBG, dega Tiranë,

³Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

për një afat prej 15 vjetësh, me 180 këste mujore totale të përbëra nga principal + interes, me interes 8.9% në vit (i papërcaktuar i ndryshueshëm sipas gjykimit të bankës dhe tregut ndërkombëtar), me kontratën nr. ***, datë 20.12.2004 dhe është plotësuar pjesa e mbetur me kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit, si dhe kursimet e dy familjeve të origjinës. Bashkëpronësi në pjesë të barabarta me bashkëshortin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente për të provuar origjinën dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

1.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.*

Faktet e rezultuara nga hetimi

1.2 Nga verifikimi i DPV-ve rezultoi se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar në vitin 2004, në rubrikën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, me përshkrimin: *apartment banimi 1+1, me sip. 65.85 m², me vlerë 5.000.000 lekë, i ndodhur në Tiranë.* Ndërsa në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar: *kredi për blerje apartment banimi, për 15 vjet, në shumën 32.000 euro, me kontratën nr. ***, datë 20.12.2004, në NBG.*

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁴, informon se: *“Nga verifikimi në sistemin elektronik digjital IPS, sipas rubrikave ‘Mbi të dhënat tekst’, si dhe ‘Mbi dokumentet e arkivës’, pranë drejtorisë sonë rezultoi se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj, nuk figurojnë pasuri”.* Ndërsa, bashkangjitur shkresës, kjo drejtori ka depozituar: (i) kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.12.2004, me palë shitëse V. I. dhe palë blerëse E.M. dhe Tereza Lani, për pasurinë apartment nr. ***, ndodhur në rrugën “****”, p. ***, k. ***, me sip. 65,85 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në vlerën 5.000.000 lekë; (ii) kartelën e pasurisë së kësaj pasurie, e cila figuron në emër të shtetasës V. S. L. .

1.3.1 Komisioni, nisur nga disa mospërputhje të konstatuara, lidhur me numrin e pasurisë dhe numrin e apartamentit, të pasqyruara në vërtetimin hipotekor dhe certifikatën e pronësisë, i ka kërkuar⁵ subjektit të qartësojë këto mospërputhje, si dhe të saktësojë statusin aktual (regjimin juridik) të kësaj pasurie. Subjekti ka depozituar shkresën⁶ të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, ku kjo e fundit konfirmon se bëhet fjalë për të njëjtën pasuri dhe se ndryshimet kanë ndodhur si pasojë e procesit të regjistrimit të zonës kadastrale. Gjithashtu, subjekti ka informuar se kjo pasuri është tjetërsuar te shtetasja V. L. me kontratën noteriale të shitjes me nr***, datë 24.7.2020, të cilën e ka depozituar me pyetësin nr. 2, datë 13.9.2021.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

1.4 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer:

- a. kredia e marrë në NBG (sot “ABI Bank”);
- b. kursimet *tona* dhe të dy familjeve respektive të origjinës.

a) Në lidhje me kredinë në NBG (sot “ABI Bank”)

1.4.i Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë marrë një kredi në NBG (sot “ABI Bank”). Kredia konfirmohet me kontratën⁷ e kredisë nr. ***, datë 20.12.2004, me palë kredidhënëse NBG dhe palë kredimarrëse Tereza Lani, E. M. dhe T. K. (G.), dorëzanës H. K., për kredinë në shumën 32.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti me adresë rruga “****”, ap. ***, sip. 65,85 m², Tiranë.

⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020.

⁵Pyetësor nr. 2, datë 13.9.2021.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2021.

⁷Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

Kredia rezultoi e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 me përshkrimin “kredi për blerje apartament banimi për 15 vjet, në shumën 32.000 euro”. Sipas kontratës së kredisë, kolateral për këtë kredi është vënë, pikërisht, apartamenti që do të merrej, si dhe pasuria e llojit njësi, me sipërfaqe 25.53 m² në emër të shtetasit H. A. K. .

1.4.ii Nga verifikimi i dokumentacionit bankar⁸ rezultoi se kredia është disbursuar në datë 21.12.2004, pra, rreth 20 ditë pas formalizimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie që datonte më 1.12.2004.

1.4.iii Në pyetësin nr. 1, subjekti, lidhur me pagesat e kryera për këtë pasuri, ka shpjeguar duke sqaruar se: “...bankat kërkonin detyrimisht që para lëvrimin të kredisë të vendosej si garanci hipotekore vetë banesa për të cilën do lëvrohej kredia, duke imponuar kështu detyrimisht lidhjen e kontratës së blerjes së pasurisë së paluajtshme/banesës para lidhjes së Kontratës së lëvrimin të kredisë, pra, që veprimi juridik i blerjes së pronës të paraprinte atë të lëvrimin të kredisë, kjo për të pasur banka siguri dhe garanci të plotë mbi banesën e hipotekuar dhe rrjedhimisht për shlyerjen e kredisë. Nga ana tjetër edhe shitësi i pasurisë së paluajtshme, apartamentit objekt financimi, shtetasi V. I., nuk pranonte që të lidhte Kontratën e shitblerjes për kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë tek ne, me rezervën e kalimit të çmimit të apartamentit pas lëvrimin të kredisë nga banka, duke kërkuar detyrimisht pagimin e shumës në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Të ndodhur në këtë situatë absurde dhe në nevojë për strehim/banim si çift i ri, kemi pranuar zgjidhjen e ofruar nga shitësi dhe Banka, duke pranuar që një pjesë e shumës/çmimit të apartamentit të na huazohej paraprakisht, po nga banka, për të likuiduar shitësin, nëpërmjet një klienti të saj të panjohur për ne, si dakordësim ky i kryer mes bankës dhe shitësit të apartamentit, për të garantuar që kjo vlerë të shkonte tek shitësi dhe nga ana tjetër Banka të financonte me kredi këtë apartament duke u derdhur kredia tek llogaria e klientit të saj, i përdorur si ndërmjetës/huadhënës për garantimin/sigurimin dhe realizimin e kësaj procedure kredie. Për këtë shkak janë nënshkruar dy deklarata noteriale prej meje dhe klientit të bankës A. B., respektivisht deklarata noteriale nr. ***, datë 1.12.2004, për marrjen e shumës prej 4.000.000 lekësh dhe pas lëvrimin të kredisë, deklarata noteriale nr. ***, datë 22.12.2004, që konfirmon kthimin e saj nëpërmjet bankës tek llogaria e tij. Ky dokumentacion dhe kjo procedurë është pjesë përbërëse e kontratës së kredisë si në anën dokumentare ashtu dhe në përmbajtjen e saj...Kështu në nenin 1.06 të kontratës së kredisë citohet shprehimisht se: ‘Banka do të derdhë shumën e kredisë në numrin e llogarisë që huadhënësi i pasurisë së paluajtshme për blerjen e së cilës po merret kredia në bazë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.12.2004, mban me Bankën Kombëtare të Greqisë Dega Tiranë (594)’”.

1.4.iv Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 1.12.2004, shtetasi A. B. deklaron se: “Në datën 1.12.2004 i ka dhënë hua pa shpërblim znj. Tereza Lani shumën 4.000.000 lekë, e cila do të përdoret nga ana e saj për blerjen e apartamentit nr.***, të ndodhur në Tiranë, rruga ***, p. ***, k. *** (gjashtë), i përbërë nga 1+1+ ambiente të tjera ndihmëse, me sip.65. 85 m², z. k. ***, me nr. pasurie ***, e regjistruar në ZVRPP-në Tirana 1, me nr. ***, datë 3.7.2000. Z. B. deklaron se shuma e mësipërme do t’i kthehet nga znj. Tereza Lani në të njëjtën vlerë por në monedhë leku ose euro ditën e lëvrimin të kredisë bankare nga Banka Kombëtare e Greqisë, mbasi kjo bankë do t’i akordoj një kredi për blerjen nga ana e saj të apartamentit të përshkruar më sipër”.

1.4.v Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.12.2004, me palë Tereza Lani dhe A. B., palët deklarojnë se znj. Tereza Lani shumën që i ka marrë hua pa interes z. A. B. prej 4.000.000 lekë të reja, në datën 1.12.2004, sot, në datën 22.12.2004, ia ka kthyer të gjithën nëpërmjet Bankës

⁸Shkresë nr. ***prot., datë 3.9.2020, nga “ABI Bank”.

Kombëtare Greke me qendër në Tiranë, shumë të cilën z. A. B., deklaroi para noterit se e ka marrë dhe nuk ka pasur vërejtje.

1.4.vi Gjithashtu, vërehet se në kontratën e kredisë nr. ***, datë 20.12.2004, në nenin 1, pika 1.06 të tij, është cituar: *“Banka do të derdhë shumën e kredisë në numrin e llogarisë, që huadhënësi i pasurisë së paluajtshme, për blerjen e të cilës po merret kredia në bazë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.12.2004, që mban me Bankën Kombëtare të Greqisë – Dega Tiranë (594)”*.

1.4.vii Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ⁹, por edhe i depozituar¹⁰ nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se kredia është disbursuar në datën 21.12.2004, në shumën 32.000 euro dhe subjekti e ka tërhequr këtë shumë në datë 22.12.2004. Po në këtë datë, subjekti ka depozituar shumën 31.480 euro në llogarinë e shtetasit A. B. me përshkrimin *“Tereza Lani likuidim i huas”*.

Komisioni pasi:

i) konstatoi se deklarata noteriale nr. ***, datë 1.12.2004, për dhënien e shumës nga shtetasi A. B. është bërë pjesë integrale e kontratës së kredimarrjes;

ii) pyeti subjektin e rivlerësimit, i cili ka qartësuar se nuk e ka njohur asnjëherë këtë shtetas, por thjesht dhe vetëm ka zgjidhur me të njëjtin kohorë të shkurtër kohorë të ofruar prej vetë bankës në favor të kredimarrjes;

iii) administroi deklaratën noteriale nr.***, datë 17.11.2021, ku shtetasi A.B. ka konfirmuar lidhur me arsyen e dhënies së shumës subjektit të rivlerësimit, *ku ndër të tjera ka deklaruar se personalisht nuk e ka njohur dhe as ka pasur ndonjë marrëdhënie, gjinie, krushqie, shoqërore apo njohje tjetër me znj. Merkaj (Lani), por për shkak të kohës së largët që ka kaluar dhe pasi ka kërkuar dokumentet që ai administron në shtëpi, ka sqaruar se znj. A. M. e ka takuar vetëm dy herë në zyrën noteriale për shkak të marrëdhënies së huas që ka pasur me të, për ta ndihmuar për një kohë të shkurtër deri në përfundimin e procedurave për lëvrimin e kredisë pasi i ishte kërkuar dhe sugjeruar nga miqtë e tij brenda dhe jashtë bankës NBG, sot ABI Bank, që si klient me llogari bankare në këtë bankë para dhe gjatë periudhës në fjalë të ndërmjetësonte mes bankës dhe kësaj shtetase për t'i dhënë huan e mundësuar për blerjen e banesës 1+1, në Tiranë, me qëllim për të likuiduar shitësin. Gjithashtu, ka deklaruar se kjo ndihmesë ka ndodhur për shkak të procedurave standard komplekse që ka pasur banka për të siguruar fillimisht hipotekën e shtëpisë dhe më tej për të akorduar kredinë. Njëkohësisht shtetasi A. B. ka deklaruar se shuma e dhënë ka pasur si burim krijimi kursimet dhe trashëgimi të gjyshërve të tij që nuk jetojnë aktualisht dhe se kjo shumë i është derdhur në llogarinë e tij bankare pas akordimit të kredisë;*

iv) mbajti korrespondencë me “ABI Bank” për t’u informuar gjerësisht lidhur me këtë situatë ndërmjetësimi për dhënien e kësaj shume deri në lëvrimin e kredisë në favor të znj. Tereza Merkaj (Lani), si dhe lidhur me politikat e tyre bankare të përdorura në raste të ngjashme të kësaj natyre dhe nga përgjigja e ardhur¹¹, konstatoi se *institucioni bankar konfirmon faktin që praktika të tilla kredidhënie janë të zakonshme dhe të ligjshme në sistemin bankar, jo vetëm për atë periudhë por edhe për periudhën e sotme dhe se dokumentacioni i pasqyruar në kontratën e kredisë është pjesë e dokumentacionit që kredimarrësit duhet të paraqesin për kreditë hipotekore dhe si të tilla janë pjesë e domosdoshme e dosjes së kredisë;*

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 3.9.2020, nga “ABI Bank”.

¹⁰Akte të depozituara me pyetësorin nr. 1, datë 22.7.2020.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2021.

vlerësoi që t'i kërkojë subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime të tjera lidhur me këtë çështje, pavarësisht se dukej që në këto kushte e rrethana ekzistonte kryesisht një marrëdhënie ndërmjetësimi nga banka mes dy individëve të panjohur me njëri tjetrin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.5 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, ndër të tjera ka deklaruar: *“...në lidhje me njërin prej burimet e krijimit të pasurisë së llojit ap.1+1, me sip. 65,85 m² (me sip.57.40 m² të rivlerësuar), të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë dhe specifiki të kredisë bankare të marrë nga ana jonë për financimin e kësaj pasurie në NBG (sot ABI Bank), u njoha me hetimin e thellë dhe të plotë të kryer nga ana e Komisionit mbi praktikën e lëvrimin të kësaj kredie, ku konstatoj që rezultatet e hetimit të thelluar (përfshirë këtu qëndrimet respektive shpjeguese të ABI Bank dhe shtetasit A. B.), konfirmojnë plotësisht faktet e parashtruara nga ana ime në mënyrë të detajuar dhe dokumentacionin përkatës shoqërues të tyre në përgjigjen e pyetjes nr. 19 të pyetësorit të parë dhe në përgjigjet e pyetjes 1 të pyetësorit të dytë”.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.6 Trupi gjykues, për të konkluduar mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të subjektit lidhur me provueshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, në analizë të dokumentacionit të administruar, përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorët përkatës, duke u ndalur kryesisht te shuma e dhënë nën ndërmjetësimin e bankës, arsyeton si vijon:

i) Sikurse rezultoi gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, si burim kryesor për krijimin/blerjen e kësaj pasurie kanë përdorur një kredi të përfituar në NBG (sot ABI Bank), fakt të cilin e kanë deklaruar saktësisht në deklaratën *Vetting* dhe DPV-në për vitin 2004.

ii) Në analizë të dokumentacionit të administruar, rezultoi se kredia është përfituar me kontratën nr. ***, datë 20.12.2004. Sipas kësaj kontrate, kolateral për këtë kredi është vënë, pikërisht, kjo pasuri, apartament, si dhe pasuria e llojit njësi me sip. 25.53 m² në emër të shtetasit H. A. K., vëllai i subjektit të rivlerësimit.

iii) Nga dokumentacioni i administruar, u konstatua se kredia është disbursuar në datën 21.12.2004, rreth 21 ditë pas formalizimit të kontratës së shitjes së pasurisë, objekt i këtij hetimi administrativ.

iv) Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar historikun e formalizimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë në datën 1.12.2004, në raport me kohën kur u përfitua dhe u disbursuar kredia, pra, arsyet e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë përpara disbursimit të kredisë, rolin e bankës kredidhënëse në përfitimin paraprak të shumës 4.000.000 lekë, veprimet bankare në kthimin e menjëhershëm të kësaj të fundit, etj.

v) Subjekti ka deklaruar se paraprakisht, përpara marrjes së kredisë, kishte marrë një shumë prej 4.000.000 lekësh nga një shtetas i panjohur i ofruar nga banka si klient i saj, për të zgjidhur një situatë të shkurtër kohore deri në disbursimin e kredisë. Kjo marrëdhënie e krijuar, sipas deklaratës të subjektit, për shkak të domosdoshmërisë së formalizimit të kontratës së shitjes së pasurisë, analizohet nga trupi gjykues në raport me: (i) arsyen e marrjes së shumës nga një shtetas i panjohur, z. A. B., për subjektin e rivlerësimit; (ii) parashikimet kontraktuale të kredimarrjes; (iii) dokumentacionin provues të nënshkruar në kohë reale mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. B.; (iv) rolin e bankës në ndërtimin e marrëdhënies midis shtetasit A. B., si klient i saj dhe subjektit të rivlerësimit; (v) marrjen e kredisë dhe destinacionin e saj, sipas kontratës së kredisë konfirmuar me gjurmë bankare; si dhe (vi) hetimin mbi gjendjen e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës, me shtetasin A. B. .

vi) Nga faktet e dala përmes hetimit në raport me deklaratimet e subjektit, se shitësi i pasurisë kushtëzonte formalizimin e kontratës përkatëse vetëm pasi të merrte të gjithë vlerën e shitjes, trupi gjykues krijon bindjen se të gjithë veprimet e kryera nga subjekti për të arrirë plotësimin e shumës përpara disbursimit të kredisë, jo vetëm janë realizuar në nivel provash, të cilat analizohen në vijim, por edhe janë kryer në kushtet e mirëbesimit. Nën këtë logjikë arsyetimi, është më se evident fakti se kushtëzimi i shitësit ka shërbyer si një faktor nxitës për subjektin për të kërkuar dhe gjetur një zgjidhje provizore për sa kohë zotëronte vetëm shumën 1.000.000 lekë deri në ato momente (burimin tjetër të deklaruar nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie), duke qenë, gjithashtu, në pritje të përfitimit të kredisë si burimi tjetër i krijimit të pasurisë.

vii) Nga ana tjetër, oferta e dhënë përmes bankës kredidhënëse për të ndërmjetësuar me një klient të saj në dhënien e shumës 4.000.000 lekë, për një periudhë të shkurtër kohore, vlerësohet nga trupi gjykues si rrethanë diktuese te subjekti për të përligjur përmbushjen e qëllimit reciprok mes palëve shitës e blerës, për blerjen e pasurisë, nën sugjerimin e një zgjidhje nga një institucion bankar. Në këtë kontekst, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të jetë trajtuar në mënyrë preferenciale apo të jetë favorizuar, lidhur me kushtet dhe termat e përfitimit të kredisë nga institucioni bankar, i cili ka konfirmuar faktin që praktika të tilla kredidhënieje janë të zakonshme dhe të ligjshme në sistemin e tyre. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe sjelljen e saj, duket se ka vepruar në mirëbesim me bankën, për sa kohë që në përmbajtjen e kontratës bankare specifikohet se qëllimi i përfitimit të saj/kredisë, është financimi i pasurisë apartament banimi.

viii) Argumenti që ky sugjerim apo që kjo ofertë ka gjetur mbështetje tek klienti i bankës për të dhënë shumën, provohet së pari nga fakti se shtetas A. B., rezultonte si klient i kësaj banke, me llogarie bankare dhe së dyti provohet edhe me deklaratën e dhënë, pikërisht, nga ky shtetas në kohë reale (në dhjetor 2004), duke pranuar dhe deklaruar dhënien e shumës në favor të subjektit, përfshirë këtu edhe kushtëzimet e deklaruara prej tij në deklaratë, për kthimin e saj në llogarinë e tij.

ix) Nga ana tjetër, fakti që kjo deklaratë është bërë pjesë integrale e kontratës së kredisë pikërisht në pikën 1.06 të nenit 1 të saj, provon rolin ndërmjetësues të kredidhënësit/bankës, por edhe ka mbështetur kushtëzimin e kredisë me destinacionin e vetëm, nga subjekti te shtetas A. B. . Niveli i provueshmërisë dhe qëllimit të marrjes së shumës, mbështetet, gjithashtu, nga fakti i kalimit të kredisë së disbursuar në mënyrë të menjëhershme me transaksion bankar nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë bankare të shtetasit A. B., veprim i cili gjithashtu është pasqyruar sërish në një tjetër deklaratë noteriale, mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit B., po në kohë reale.

x) Në vazhden e argumenteve sipërcituar, lehtësisht konstatohet se për një afat të shkurtër (provizor) kohor, vetëm 21 ditë, kanë ndodhur disa veprime mes palëve kredidhënëse - kredimarrës, shitësit të pasurisë dhe shtetasit A. B., të cilat janë konkretizuar në nivel provash, pa pretendime mes palëve në kohën e ndodhisë së tyre dhe as në vijimësi.

xi) Në këtë rend kronologjik përfshihet edhe fakti se të gjithë veprimet janë kryer jo vetëm brenda një viti kalendarik (2004), por brenda një muaji të këtij viti kalendarik dhe, për pasojë, subjekti ka deklaruar saktë dhe plotësisht, pikërisht, veprimin e fundit, pra, përfitimin e kredisë për të cilën ka pasur edhe detyrimin e shlyerjes në vijimësi.

xii) Trupi gjykues, nisur nga faktet dhe rrethanat e dala gjatë hetimit dhe më konkretisht:

- duke çmuar dhe analizuar informacionin e dhënë nga banka kredidhënëse si institucion legjitim, e cila ka konfirmuar zyrtarisht rolin e saj si ndërmjetësuese për t'i ofruar përkohësisht subjektit të rivlerësimit, si huadhënëse klientin e saj, për sa kohë ka informuar *se praktika të tilla kanë ekzistuar dhe ekzistojnë dhe se praktika të tilla kredidhënieje janë të zakonshme dhe të ligjshme në sistemin bankar*; si dhe

- duke analizuar deklaratën e bërë nga shtetasi A. B., i cili konfirmon se *nuk ka pasur asnjë njohje gjinie, krushqie, etj., me subjektin e rivlerësimit, por për shkak të procedurave komplekse të bankës në lëvrimin e kredisë ka pranuar ndërmjetësimin e bankës si klient i saj që ti jepte subjektit këtë shumë,*

arrin në konkluzion se jo vetëm mbështeten deklaratimet konsistente të subjektit se nuk e ka njohur këtë shtetas, por këto fakte të ndërthurura me veprimet dhe transaksionet e kryera në kohë reale nga subjekti i rivlerësimit për financimin e çmimit të blerjes së pasurisë apartament banimi, çmohen të tilla që nuk e vendosin subjektin në kushtet e paligjshmërisë së burimit për krijimin e saj, për sa kohë provohet se ato janë karakterizuar nga një marrëdhënie ndërmjetësimi nga një institucion legjitim, pra, nuk konfirmohet një marrëdhënie huaje sipas parashikimit të Kodit Civil dhe, si të tilla, vlerësohen nga trupi gjykues si rrethana përjashtuese për subjektin e rivlerësimit, nga detyrimi ligjor sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

xii) Trupi gjykues arrin në këtë vlerësim, edhe për faktin se në këtë çështje ka vërejtur që rol aktiv dhe vendimtar në përfitimin e shumës ka pasur banka, ndërsa subjekti është gjendur në rolin e tij pasiv dhe, për më tepër në kushtet e mirëbesimit.

xiii) Një faktor tjetër i rëndësishëm që merr vlerë në këtë logjikë arsyetimi është edhe konfirmimi i institucioneve punëdhënës të subjektit të rivlerësimit se prej saj/subjektit, përgjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare, prej fillimit dhe deri aktualisht nuk ka rezultuar gjykimi i ndonjë çështje të çdo lloji natyre gjykimi, me këtë shtetas, duke u përjashtuar kështu edhe çdo konflikt i mundshëm interesi. Gjithashtu, trupi gjykues në asnjë rast përgjatë hetimit në tërësi të kësaj çështjeje, nuk ra në dijeni të faktit të njohjes së subjektit të rivlerësimit me shtetasin A.B. .

xiv) Gjithashtu, trupi gjykues, në respektim të standardit të krijuar deri aktualisht, në raport me hetimin dhe vlerësimin e kësaj çështjeje objekt i hetimit administrativ, por edhe në referencë, gjithashtu, të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹², e vlerësoi analizën e kësaj çështjeje objekt hetimi krahasuar me çështje të tjera, të cilat në dukje prezantohen si të ngjashme. Në këtë kontekst rezultoi se çështja objekt hetimi nuk paraqet të njëjtën panoramë me çështje të tjera, qoftë në aspektin e deklarimeve të subjektit, pasi ato kanë rezultuar të jenë në vijueshmëri konsistente dhe jo kontradiktore, por dhe në aspektin e nivelit të provueshmërisë së pretendimeve, të cilat në këtë rast nuk kanë mbetur në nivel deklarativ, por janë mbështetur me një mori provash të realizuara në kohën e kryerjes së veprimeve. Në këtë raport krahasimor, rezultoi se përkundër ndonjë rasti tjetër, trupi gjykues arriti në konkluzionin e mësipërm, pasi subjekti i rivlerësimit znj. Merkaj, rezultoi se: (a) nuk kishte nënshkruar një kontratë shitjeje më përpara marrjes së huas, por e kishte kryer këtë veprim pikërisht me marrjen e saj; (b) huaja e marrë kishte pasur si destinacion blerjen e apartamentit objekt hetimi; (c) deklarata për marrjen e huas ishte bërë pjesë integrale e kontratës së kredisë, ku në asnjë praktikë me rast të ngjashëm me parë nuk ka qenë evidentimi këtij fakti. Kjo deklaratë ka të përshkruar edhe pasurinë që do blihej, duke specifikuar të dhënat e plota të saj, si dhe duke parashikuar edhe kthimin e saj, me kredinë sapo të lëvrohej; (ç) huaja ishte shlyer nga subjekti, brenda muajit të të njëjtit vit kalendarik, menjëherë me marrjen e kredisë, me transaksion bankar; si dhe (d) subjekti në mënyrë konsistente ka pohuar se nuk e ka njohur huadhënësin dhe reciprokisht edhe huadhënësi ka pohuar të njëjtin fakt. Nën evidentimin e rrethanave të ndryshme të rastit objekt shqyrtimi, trupi gjykues çmon se krahasimisht me raste të tjera, çështja objekt vlerësimi nuk paraqet të njëjtën panoramë me subjekte të tjera, si në aspektin e deklarimeve, apo edhe në aspektin e nivelit të provueshmërisë së pretendimeve dhe, për pasojë, në tërësi është konkluduar se nuk ndodhemi përpara të njëjtës zgjidhje.

xv) Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzion se mbështetur në faktet dhe rrethanat e dala gjatë hetimit administrativ, si dhe në provat e materializuara në tërësi, se shumica prej

¹²Vendimi nr. 19/2021.

4 000 000 lekë, për të blerë këtë pasuri në vitin 2004, do të konsiderohet si e krijuar me burime të ligjshme dhe, për pasojë, pa pasoja negative në vlerësimin e burimeve të krijimit të pasurisë “apartament”, me nr. pasurie ***, ZK. ***, rruga “***”, ap. ***, Tiranë.

b) Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të kësaj pasurie, cilësuar nga subjekti, *kursimet tona dhe të dy familjeve tona të origjinës*

1.7 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore. Në vërtetimet e punësimit të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pasqyrohen dhe konfirmohen nga këto të fundit të ardhurat e përfituara. Në analizën financiare të kryer për pasurinë e paluajtshme, janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj përgjatë vitit 2004. Gjatë hetimit, subjekti ka depozituar, gjithashtu, edhe dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituara nga familjarët respektivë.

1.8 Në analizën e kryer nga Komisioni, në termin *kursime* janë përfshirë vetëm të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2004, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

1.9 Komisioni kreu analizën financiare për investimin e kryer duke marrë në konsideratë: (i) huan në shumën 4.000.000 lekë, për faktet e sipërcituara; si dhe (ii) kursimet e realizuara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj përgjatë vitit 2004, kur është kryer investimi.

1.10 Meqenëse subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë hyrë në marrëdhënie huamarrje me familjarët respektivë, ndihmesa e dhënë prej tyre është përfshirë në burimin e krijimit në pasuritë e analizuara më poshtë në këtë vendimmarrje, për të cilat Komisioni ka kryer përlllogaritjet përkatëse. Kjo ndihmë e familjarëve nuk u përfshi në këtë pasuri edhe për faktin e mos përcaktimit të një vlere të saktë nga subjekti i rivlerësimit, se sa kishte qenë kontributi i tyre.

1.11 Në këtë analizë financiare, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deklarimin e subjektit për mbulimin e shpenzimeve të bashkëshortit, nga organizatorët, për dy udhëtime pune, *identifikuar në zërin shpenzime TIMS, në vlerën 282.630 lekë*, pasi në gjendjen që rezultonin provat, ky rezultat nuk provohet me dokumentacion provues.

1.12 Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 365.845 lekë, që të investonte në pasurinë apartament, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës¹³ për të dhënë argumentet e saj në lidhje me konstatimet e bëra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.13 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj lidhur me kursimet e tyre si bashkëshortë dhe të dy familjeve të origjinës, ka sqaruar se shuma prej 282.630 lekësh e llogaritur për dy udhëtimet e bashkëshortit respektivisht në Hungari dhe në Egjipt është përfshirë në mënyrë të gabuar në analizën financiare për vitin 2004, në zërin e shpenzimeve, si shpenzime të këtij viti nga të ardhurat e tyre familjare, duke pretenduar se të dyja këto udhëtime janë mbuluar nga organizatorët e tyre, donator/partner ndërkombëtarë/institucionet shtetërore homologe të vendeve ku janë zhvilluar këto trajnime respektive. Subjekti, për të provuar këtë fakt, ka depozituar me cilësinë e provës dy certifikatat e përfituara nga bashkëshorti në përfundim të trajnimeve¹⁴, respektivisht nga Programi Mbështetës Antiterrorizëm i Byrosë së Sigurisë diplomatike të Departamentit të Shtetit Amerikan (trajnim i zhvilluar në periudhën 11-15 tetor 2004, në Budapest, Hungari), si dhe nga fondi i vendeve të Komonwelthit në kuadër të

¹³Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁴Pjesë e dokumentacionit provues është dhe një urdhër nr. ***, datë 7.10.2004, i Ministrisë së Rendit Publik për përcaktimin e ekipit për shërbim jashtë shtetit shqiptar.

bashkëpunimit ndërkombëtar të Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe Ministrisë së Jashtme të Egjiptit (kjo e fundit me temë “mbrojtjen e kufijve dhe garantimin e sigurisë kundër migracionit të parregullt”, zhvilluar në periudhën 4.8.2004 – 2.9.2004, në Kajro, Egjipt, financuar nga Republika Arabe e Egjiptit)¹⁵.

Subjekti ka kërkuar që në vlerësim të shpjegimeve dhe të akteve provuese, si më sipër, të konsiderohen dhe të zbritet nga shuma prej 365.854 lekësh, shuma 282.630 lekë, e llogaritur në zërin e shpenzimeve për dy udhëtimet e bashkëshortit në analizën financiare të vitit 2004.

Edhe për sa i përket vlerës së mbetur prej 83.215 lekësh (diferenca e mbetur 365.854 lekë - 282.630 lekë), subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është mbuluar nga familja e saj e origjinës, e cila bazuar në dokumentacionin provues që ka vënë në dispozicion me pyetësorët nr. 1 dhe 2, në vitin 2004 dhe në vijim, ka pasur burime të ligjshme dhe të ardhura të konsiderueshme (nëna punësuar në “A.”, si ekonomiste me pagë të lartë dhe njerku me aktivitet tregtar), për të kontribuar dhe për të më ndihmuar financiarisht në blerjen e kësaj pasurie.

Gjithashtu, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare, lidhur me shpenzimet e udhëtimit për vitin 2004, të konsiderohet fakti që nga data 21.10.2003¹⁶ gjatë periudhës së stazhit në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht, për periudhën 21.10.2003 – 1.12.2004, ka banuar në qytetin e Elbasanit¹⁷ bashkë me familjen e saj të origjinës, duke vijuar, gjithashtu, në parashtrimet e saj se për këtë fakt ka dhënë shpjegime të detajuara në përgjigjen e pyetjes 1 të pyetësorit të parë. *Për shkak të lidhjes, afeksionit, përkujdesjes, përkushtimit e ndihmës së përhershme e të pakursyer të ndërsjellë që ka ekzistuar dhe vijon ende mes anëtarëve të familjes shqiptare (është shprehur subjekti), prindërit nuk kanë pranuar asnjë kontribut në vlerë monetare prej meje për gjithë periudhën e qëndrimit tim me ta.*

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur në pronësi asnjë automjet, për periudhën 21.10.2003 – 1.12.2004, si dhe ka udhëtuar në drejtim të qytetit të Durrësit me transport publik, autobus në linjën Elbasan-Durrës dhe anasjelltas duke paguar një vlerë 350 lekë/ditë. Po ashtu, përgjatë vitit të dytë të ushtrimit të detyrës, pra, për periudhën nëntor 2013 - 1.12.2004 (kur dhe është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë), ka banuar me bashkëshortin dhe vajzën e madhe në Tiranë, në apartamentin e tyre të parë 1+1, të ndodhur në rrugën “***”, të tjetërsuar tashmë dhe se ka shfrytëzuar sërish transportin publik të linjës Tiranë-Elbasan dhe anasjelltas, duke paguar një çmim prej 300 lekësh në ditë (duke përjashtuar në llogaritjen e shpenzimeve për udhëtim këtu edhe periudhën e muajit Gusht përgjatë vitit 2004, periudhë kjo ku si gjithë magjistratët e tjerë në detyrë ka ezauruar lejen vjetore sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi në atë kohë). Lidhur me përllogaritjen e kryer në analizën financiare, subjekti ka kërkuar, gjithashtu, që të konsiderohen shpjegimet e saj mbi këto fakte, si dhe parashikimet ligjore të përcaktuara në VKM-në nr. 4, datë 10.1.1994 dhe VKM-në nr. 146, datë 26.2.1998, të cilat përcaktojnë vlerën e tarifave të transportit publik të udhëtarëve për udhëtimet brenda territorit të Shqipërisë, referencë kjo që ka shërbyer si bazë ligjore edhe në analizën dhe arsyetimin e përdorur në vendimin nr. 208, datë 8.11.2019, të Komisionit ndaj subjekti D. Sh., në të cilin është pranuar se përllogaritja e çmimeve, në lidhje me kostot e transportit publik për udhëtimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, realizohet sipas parashikimeve të këtyre akteve normative të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit. Metodologjia e përdorur nga Komisioni, për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, i referohet vendimit nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit (pikës 27.7 e në vijim), i cili përcakton metodologjinë për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit dhe jo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

¹⁵Detajet janë specifikuar në përmbajtjen e vetë certifikatave ligjëruese të zhvillimit të këtyre trajnimeve dhe mbulimit të shpenzimeve të tyre nga organizatorët, partnerët ndërkombëtarë.

¹⁶Në këtë datë mbi bazën e Dekretit nr. 3983, datë 21.10.2003, të Presidentit të Republikës, jam emëruar dhe kam filluar të ushtroj në periudhë stazhi funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹⁷Kam udhëtuar çdo ditë pune në drejtim të qytetit të Durrësit me mjete të transportit publik.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.14 Trupi gjykues, duke analizuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të kryer disa rillogaritje në analizën financiare dhe konsideruar ato në harmoni me provat e administruara, ka konkluduar në vlerësimin e kryerjes së disa rillogaritjeve nga Njësia e Shërbimit Ligjor, të cilat passollën balancë pozitive, si në vijim.

i) Më konkretisht, bazuar në aktet e depozituara dhe të analizuara, në vijim:

- urdhër nr. ***, datë 7.10.2004, i Ministrit të Ministrisë së Rendit Publik, për shërbimin jashtë shtetit (në Hungari), në të cilin rezulton i listuar emri i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për udhëtimin me datë nisje më 10.10.2004 dhe kthim më 16.10.2004;
- faktin se ky urdhër i drejtohet edhe sektorit të financës, që të pajisë personat e listuar me valutën e nevojshme për shpenzimet e vogla, si dhe me para për taksën aeroportuale;
- faktin se në këtë urdhër citohet se fondet për këto shpenzime do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2004, për Ministrinë e Rendit Publik dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- certifikatën e përmbushjes së trajnimit për datat 11-15 tetor 2004, Budapest, Hungari;
- certifikatën e përmbushjes së trajnimit për datat 4.5.2004- 2.9.2004, Egjipt, ku fondet janë mbuluar tërësisht nga ky i fundit, për shkak të trajnimeve të ofruara për administratën publike shqiptare, përmes bashkëpunimit ndërkombëtar (institucioneve përkatëse shqiptare dhe të shtetit të Egjiptit),

trupi gjykues konkludon se provohet fakti që shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët dhe se pas marrjes së tyre në konsideratë, diferenca e mbetur është në një vlerë të papërfillshme prej 83.215 lekësh, vlerë e cila rezulton lehtësisht e mundur për t'u dhuruar nga familjarët e subjektit dhe bashkëshorti, konkluduar kjo sipas analizës së kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, detajuar në pikat ku janë analizuar mundësitë e dhënies së huave prej familjarëve respektivë.

iii) Ndërsa, në lidhje me kostot e transportit, trupi gjykues çmon se edhe pse në këtë pasuri vlerat nuk kanë ndonjë ndikim, përsëri ato vlerësohen të merren në konsideratë, sikurse subjekti ka pretenduar se ka përdorur transportin publik, duke llogaritur koston ditore në masën 500 lekë/ditë.

iv) Trupi gjykues, në përfundim të kësaj analize, bazuar në faktet dhe provat e materializuara, arrin në konkluzion se subjekti rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie.

1.8 Në lidhje me ndonjë *trajtim preferencial* të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie, Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 1, datë 4.3.2004, për miratimin e koston mesatare të ndërimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2004. Sipas këtij udhëzimi, rezulton se vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2004, për qytetin e Tiranës, ishte 68.571 lekë/m².

- Nga hetimi rezultoi se apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti është me sipërfaqe 57.54 m². Bazuar në çmimet referuese, përlllogaritjet tregojnë se vlera e apartamentit është 3.935.975 lekë. Kjo vlerë është më e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 5.000.000 lekë. Diferenca prej 1.064.025 lekësh (5.000.000 - 3.935.975), më shtrenjtë nga çmimet e tregut, vlerësohet se përkon pikërisht me vlerën e mobilimit, ashtu sikurse ka deklaruar edhe subjekti se kjo pasuri është blerë e mobiluar.

- Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

1.9 Në lidhje me gjendjen e *konfliktit të interesit*, Komisioni ka mbajtur korrespondencë me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në përgjigjet¹⁸ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit V. V. I. (shitësi i apartamentit) dhe A. M. B. (huadhënësi provizor).

- Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

2. Pasuri e paluajtshme, apartament 2+1, me sip. 88.82 m², me nr. pasurie ***, z. k***, ap. ***, ndodhur në rrugën “***”, Tiranë. Kjo pasuri është blerë e mobiluar nga bashkëshorti i subjektit me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.7.2011, në vlerën 5.329.200 lekë. Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer huaja e marrë në vlerën 5.000.000 lekësh, me interes 6% në vit, nga bashkëshorti E. M., shtetasit A. P. (lidhje shoqërore e tij, shihni të dhënat konfidenciale), e vërtetuar kjo me deklaratë huaje, datë 14.7.2011. Pjesa e mbetur e vlerës së banesës së blerë është plotësuar nga të ardhurat e përbashkëta vjetore. Bashkëpronësi në pjesë të barabarta me bashkëshortin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente provuese.

2.1 ILDKPKI në raportin e saj ka konstatuar: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet. Huadhënësi rezulton me aktivitet privat prej vitit 2008.*

Faktet e rezultuara nga hetimi

2.2 Nga verifikimi i DPV-ve rezultoi se subjekti rivlerësimit këtë pasuri e ka deklaruar në vitin 2011 me përshkrimin: blerje apartamenti me sip. 88.82 m² me adresë rruga “***”, kulla nr. ***, pasuria nr. ***, në z. k. ***, në regjistri hipotekor ***, datë 15.5.2008. Blerë nga bashkëshorti me kontratën nr. ***, datë 15.7.2011. Çmimi i blerjes 5.329.200 lekë. Ndërsa në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar: deklaratë huamarrje midis bashkëshortit dhe shtetasit A.P., datë 14.7.2011, me 6% interes, pa afat deri në shitjen e apartamentit 1+1, me adresë rruga “***”, p. ***K, ap***, me regjistër hipotekor***, datë 8.12.2004, pasuri me nr. ***, z. k. ***. Vlera: 5.000.000 lekë.

2.3 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Jug¹⁹ konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të shtetasit E. S. M. . Kjo drejtori ka bashkëlidhur kontratë shitblerje nr. ***, datë 15.7.2011, me palë shitëse E. dhe S. V. dhe palë blerëse E. M., të pasurisë apartament me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 88,82 m², me çmim shitje në vlerën 5.329.200 lekë.

2.4 FSHU-ja²⁰ informon se me gjeneralitetet Tereza B. Merkaj (Lani), referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton abonent. Me gjeneralitet E.M., referuar të dhënave sistemit të faturimit, identifikohet 1 (një) abonent me kontratën e furnizimit me Nr. ***, në instancën Tiranë.

2.4.1 Subjektit i është kërkuar²¹ të depozitojë librezën, që i përket kontratës për furnizimin me energji elektrike me FSHU-ja, për këtë pasuri dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka depozituar librezën, e cila rezulton e hapur në emër të shitësit të pasurisë E. V. .

2.5 UKT-ja²² nuk ka konfirmuar kontratë për furnizimin me ujë në emër të subjektit dhe bashkëshortit.

¹⁸Shkresë nr.*** prot., datë 8.10.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe shkresë nr. *** prot, datë 28.10.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2020.

²⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2020.

²¹Me pyetësorin nr. 2, datë 13.9.2021.

²²Me shkresën nr. ***prot., datë 18.9.2020.

2.5.1 Subjektit i është kërkuar²³ të depozitohet librezën përkatëse që i përket kontratës për shërbime të UKT-së, për këtë pasuri dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka depozituar librezën, e cila rezulton e hapur në emër të shitësit të pasurisë E.V. .

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

2.6 Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* se burim krijimi i kësaj pasurie janë: (a) huaja e marrë në vlerën 5.000.000 lekë nga shtetasi A.P.; si dhe (b) të ardhurat vjetore.

a. Në lidhje me marrjen e huas në vlerën 5.000.000 lekë

2.6.i Subjekti i rivlerësimit e deklaron këtë hua në kohë reale, në deklaratën periodike të vitit 2011. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar deklaratën e vitit 2011 (jo noteriale). Në këtë akt bashkëshorti i subjektit deklaron se i ka marrë hua shtetasit A.P. shumën 5.000.000 lekë dhe se do ta kthejë, pasi të realizohet shitja e apartamentit 1+1, me adresë rruga “****”, p. ***, ap. ***, me regjistër hipotekor nr. ***, datë 8.12.2004, pasuri me nr. *** z. k. ***.

2.6.ii Nga korrespondenca e Komisionit me ILDKPKI-në, kjo e fundit²⁴ ka vendosur në dispozicion procesverbalin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit dhe dokumentacionet e depozituara në vite. Më konkretisht, për pasurinë objekt vlerësimi ka depozituar:

- Deklaratën e datës 14.7.2011, ku shtetasi E. M. (bashkëshorti i subjektit) deklaron se i ka marrë shtetasit A.P. shumën 5.000.000 lekë, me 6% interes, pa afat kohor, duke marrë përsipër t’ia kthejë këtë shumë sapo të realizohet shitja e apartamentit 1+1, p. ***, rruga “****”, ap. ***, me regjistër hipotekor ***, datë 8.12.2004, pasuri me nr. ***, z. k. ***.

- Për vitin 2012, deklaratën e bashkëshortit, e cila mban datën 7.12.2012, ku citohet se shtetasi E. M. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) i ka kthyer shtetasit A. P. shumën 5.000.000 lekë së bashku me shumën 425.000 lekë që është shuma e 6% interes (në vit).

2.6.iii Në pyetësorin nr. 1, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr****, datë 26.6.2018, ku shtetasi A. L. P. deklaron mbi marrëdhëniet e tij të huas me shtetasin E.M. . Ai deklaron se shumata e huave të dhëna prej tij i janë likuiduar tërësisht sipas deklaratave respektive të huave të nënshkruara mes tij dhe z. E. M., me shkrim dore. Më konkretisht: për huan e parë është nënshkruar deklaratë në datën 29.7.2009, hua e shlyer me deklaratën e datës 17.9.2009 dhe për huan e dytë, është nënshkruar deklaratë e datës 14.7.2011, hua e shlyer me deklaratën e datës 7.12.2012. Shtetasi A. P., gjithashtu, deklaron se shuma që i ka dhënë hua shtetasit E. M. është krijuar nga të ardhura të tij të ligjshme të fituara nga aktiviteti tregtar që zotëron, bizneset e tij, si dhe kursimet ndër vite.

2.6.iv Komisioni e ka pyetur²⁵ subjektin mbi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 5.000.000 lekë nga shtetasi A.P., si dhe i ka kërkuar të depozitonte dokumentacion justifikues mbi këto të ardhura.

2.6.v Subjekti depozitoi:

- certifikata regjistrimi për 6 shoqëri të ndryshme, për të evidentuar faktin se z. A. P. kishte ushtruar aktivitet tregtar që prej vitit 1996 nëpërmjet shoqërive të ndryshme që ai zotëronte si ortak i vetëm apo në bashkëpronësi;

- shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë²⁶ (në vijim DRT) lidhur me fitimin e shoqërisë “****” sh.p.k., ku z. A.P. është administrator dhe ortak. Kjo drejtori ka informuar mbi fitimin e shoqërisë “****” sh.p.k., për vitet 2007 – 2011, të cilin Komisioni e ka pasqyruar në tabelën në vijim;

²³Me pyetësorin nr. 2, datë 13.9.2021.

²⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2020.

²⁵Pyetësor nr. 2, datë 13.9.2021.

²⁶Nr*** prot., datë 16.09.2021, depozituar me pyetësorin nr. 2.

Tabela nr. 1

Viti	Fitimi <i>neto</i>
2007	974,386
2008	8,994,077
2009	8,330,593
2010	5,469,078
2011	3,125,622
Total 2007-2011	26,893,756

- shkresë nga DRT-ja Tiranë²⁷, lidhur mbi fitimin e shoqërisë “****” sh.p.k., ku z. A. P. rezulton të jetë administrator dhe ortak. Kjo drejtori ka informuar mbi fitimin e shoqërisë, për vitet 2008 – 2011, të cilin Komisioni e ka pasqyruar në tabelën në vijim;

Tabela nr. 2

Viti	Fitimi <i>neto</i>
2008	-
2009	-
2010	328,870
2011	980,927
Total 2008 - 2011	1,309,797

- vërtetim për bazën e vlerësuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë (në vijim DRSSh), për punësimin e z. A. P., pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për vitet 2004-2007;

- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSH), Drejtoria e Arkvit Qendror, për punësimin e z. A. P., pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për vitet 2008 - 2012.

- librezë depozitash në “Tirana Bank”, ku z. A. P. figuron me një depozitë në shumën 4.300.000 lekë, të çelur që prej datës 12.8.2004. Në të vërehet se ka transaksione si depozitime dhe tërheqje;

- librezë kursimesh, në shtetin grek, në bankën e kursimeve, në shumën 4.130.000 GRD²⁸ që prej vitit 1994, ku vërehet se ka transaksione si depozitime dhe tërheqje;

- librezë kursimesh, në shtetin grek, depozitë në monedhën USD, në shumën 3.000 USD që daton prej vitit 2000, ku vërehet se ka transaksione si depozitime dhe tërheqje;

- statement (nxjerrje llogarie) nga “Tirana Bank”, llogari në emër të shtetasit A. P., prej vitit 2004 dhe në vazhdim, ku evidentohen transaksione, depozitime/tërheqje, likuidime nga klientë, etj., në vlera të konsiderueshme.

2.6.vi Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, Komisioni hetoi, gjithashtu, për shtetasin P. .

Komisioni i kërkoi shoqërisë “****” sh.p.k., informacion mbi bilancet dhe kartelën e ortakut A.P. . Në përgjigje, shoqëria²⁹:

- depozitoi bilancet e kërkuara nga Komisioni, për vitet 2007 – 2011;

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 17.09.2021, depozituar me pyetësin nr. 2.

²⁸Dhrahmi greke

²⁹Përgjigje, datë 6.10.2021, për shkresën nr. ***prot., datë 29.9.2021, të Komisionit.

- informoi se kartelën e shtetasit A. P. për të evidentuar tërheqjet dhe depozitimet, huat dhe kthimet e tyre, nuk e dispononte për shkak të periudhës së largët kohore mbi 10 vjet. Por, për të përmbushur kërkesën e Komisionit, shoqëria ka vendosur në dispozicion ekstraktin bankar të shoqërisë “****” sh.p.k., në “Tirana Bank”;
- depozitoi dy vendime të ortakut, shtetasit V.P., për dhënie hua, konkretisht vendimin e datës 27.7.2009, për dhënie të shumës 3.075.000 lekë dhe vendimin e datës 14.6.2011, për dhënie të shumës 6.500.000 lekë;
- depozitoi prokurën e posaçme nr. ***, datë 13.9.2007 dhe prokurën e përgjithshme nr. ***, datë 30.7.2009, ku autorizohet shtetasi A. P. për të kryer veprime të pakufizuara në emër të shoqërisë;

2.6.vii Komisioni, në analizim të dokumentacionit të depozituar, konstatoi se:

- shtetasi A. P. ka tërhequr nga llogaria bankare e shoqërisë “****” sh.p.k., në “Tirana Bank”, në shumën 3.075.000 lekë, në datën 29.7.2009. Kjo shumë përputhet me shumën e përcaktuar në vendimin e ortakut për dhënien e kësaj huaje. Gjithashtu, data e shumës së tërhequr 29.7.2009, korrespondon edhe me datën e marrjes së shumës 2.400.000 lekë³⁰, që i përket huas së parë të marrë këtij shtetasi, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, por edhe me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 29.7.2009, ku bashkëshorti E. M., deklaron se i ka marrë 2.400.000 lekë hua shtetasit A.P., ditën e sotme, pa afat kohor të përcaktuar për kthimin e tyre dhe pa përqindje për këtë shumë.

- shtetasi A. P. ka tërhequr nga llogaria bankare e shoqërisë “****”, sh.p.k., në “Tirana Bank”, në shumën 6.500.000 lekë, në datën 14.06.2011. Kjo shumë përputhet me shumën e përcaktuar në vendimin e ortakut, për dhënien e kësaj huaje dhe rezultoi tërhequr 1 muaj para dhënies së huas bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vlerën 5.000.000 lekë. Në deklaratën *Vetting*³¹, por edhe në ILDKPKI³², subjekti ka depozituar deklaratën e huas, datë 14.7.2011, dhënë ndërmjet shtetasve E.M. dhe A.P., të cilët deklarojnë se shtetasi E. M. i merr shtetasit A. P. shumën prej 5.000.000 lekësh, me 6% interes, pa afat kohor, duke marrë përsipër njëkohësisht edhe sipas vullnetit të A.P. t’ia kthejë këtë shumë sapo të realizohet shitja e apartamentit****, rruga “****”, me nr. regjistër hipotekor ***, datë 8.12.2004, pasuri me nr. ***, z. k****.

2.6.viii Shtetasi A. P. deklaron se këto hua të marra nga shoqëria janë kthyer pret tij brenda vitit financiar.

Nga kontrolli i bilanceve, Komisioni ka vërejtur se zëri i të drejtave dhe detyrimeve ndaj ortakëve është në vlerën 0 (zero), fakt ky që përputhet edhe me deklarinimin e shtetasit A. P. se në fund të vitit nuk ka qenë debitor ndaj shoqërisë.

2.6.ix Nisur nga faktet dhe rrethanat e dala gjatë hetimit administrativ, si: (a) përgjigjet e subjektit; (b) deklaratat e kohës; (c) dokumentacioni i depozituar prej subjektit për provueshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua; (ç) hetimi i kryer prej Komisionit; si dhe (d) fakti që shumat e huave përbëhen nga fondet e shoqërisë, veprime të provuara me tërheqjet nga llogaria bankare e shoqërisë, si dhe kontabilizimi i tyre në bilancin e saj, tregojnë se shtetasi A.P. ka pasur mundësi financiare që t’i japë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të dyja huat, përkatësisht shumën 2.400.000 lekë në vitin 2009 dhe shumën 5.000.000 lekë në vitin 2011.

³⁰ Kjo hua është trajtuar më poshtë në këtë vendimmarrje.

³¹ Aneks nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së

³² Dokumentacioni i depozituar në vite dhe në procesverbalin e mbajtur, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2020, nga ILDKPKI-ja.

b. Në lidhje me të ardhurat vjetore

2.6.x Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se në vërtetimet e punësimit të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pasqyrohen të ardhurat e përfituara, të cilat konfirmohen nga këto institucione. Në analizën financiare për pasurinë e paluajtshme, u përfshinë të ardhurat e përfituara nga subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti deri në momentin e investimit.

2.6.xi Trupi gjykues, pasi kreu nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare në datën e investimit, duke marrë në konsideratë huan, i rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare, të investojë në pasurinë apartament, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

2.6.xii Nën këtë analizë ligjore dhe financiare, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua nga shtetasi A. P., bazuar në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- Në lidhje me shlyerjen e huas, në shumën 5.000.000 lekë

2.6.xiii Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti deklaroi shitjen e pasurisë së paluajtshme, apartament 1+1, me adresë, rruga “****”, p. ***, shk. ***, kat. ***, Tiranë, me kontratën nr. ***, datë 6.12.2012, në vlerën 5.500.000 lekë.

2.6.xiv Gjithashtu, subjekti deklaroi shlyerje të huas në datën 7.12.2012, nga bashkëshorti A.P., në vlerën 5.425.000 lekë.

2.6.xv Shitja e kësaj pasurie konfirmohet nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri³³. Kjo drejtori ka depozituar të njëjtën kontratë që ka vendosur në dispozicion³⁴ edhe subjekti i rivlerësimit. Në kontratë është parashikuar edhe detyrimi i palës shitëse për të paguar tatimin 10% (në vlerën 152.812,5 lekë) të diferencës midis çmimit të shitjes dhe blerjes³⁵.

2.6.xiv Nga akseset *online* i Komisionit në sistemin multifunksional të ASHK-së, rezultoi se kjo pasuri nuk ekziston në emër të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të.

2.6.xv Trupit gjykues, pas analizimit të dokumentacionit lidhur me këtë shitje, nuk i kanë rezultuar problematika. Kontrata e shitjes, e hartuar pranë noterit, rezultoi sipas legjislacionit civil për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve të cilët janë likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale, si dhe është regjistruar në hipotekë në favor të blerësit.

2.6.xvi Gjithashtu, rezultoi se pas shitjes së kësaj pasurie, bashkëshorti i subjektit ka nënshkruar deklaratën e datës 7.12.2012, për shlyerjen e huas së marrë në datën 14.7.2011. Huaja është shlyer në shumën 5.425.000 lekë³⁶, vlerë kjo sipas parashikimit të deklaratës së huas. Pra, nga përlllogaritjet rezultoi se huaja është likuiduar me shumën e përfituar nga shitja e pasurisë, përfshirë edhe interesin prej 6% në vit, nga data e marrjes së saj/huas.

2.6.xvii Trupi gjykues, kreu përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare për vitin 2012 dhe nga përlllogaritjet nuk i rezultuan problematika për/në shlyerjen e kësaj huaje.

3. Pasuri e luajtshme automjet, tip “Mercedez-Benz” **, viti 2006, ngjyrë gri, me targa ****, në pronësi të deklarueses, përfituar sipas kontratës noteriale të shkëmbimit të automjeteve, me nr****, datë 20.7.2016 e lidhur midis deklarueses dhe shtetasit D.M. . Vlera: 4.000 euro (referuar vlerës së automjetit të parë të shkëmbyer sipas kontratës noteriale nr. ****, datë**

³³Sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.12.2020.

³⁴Referojuni Aneksit nr. 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵5.500.000 – 3.971.875 =1.528.125 lekë.

³⁶425.000 lekë është interesi 6% për periudhën 1 vit e 5 muaj nga marrja e huasë.

21.11.2012, shihni deklaratën e pasurisë së vitit përkatës). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente provuese.

3.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR.*

Faktet e rezultuara nga hetimi

3.2 Meqenëse ky automjet vjen si pasojë e një kontrate shkëmbimi, Komisioni ka kryer hetimin duke filluar që nga zanafilla e transaksioneve të shkëmbimit të automjeteve.

3.3 DPSHTRR-ja, me shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2020, informon se shtetasja Tereza B. Merkaj ka pasur në pronësi automjetet me targa AA ***, AA ***, AA ***, AA ***. Kjo drejtori, ka depozituar për secilën targë dosjen përkatëse, ku në mënyrë kronologjike identifikohen targat, pronarët fillestarë, ndryshimet e pësuar në targat e automjeteve, si dhe zotëruesit aktual.

3.4 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012, subjekti ka deklaruar në rubrikën e ndryshimit të pasurive: *kontratë blerje automjeti nr. ***, datë 20.11.2012. Vlera: 4.000 euro.*

3.4.1 Me këtë kontratë rezultoi se është blerë automjeti “Daimler Crysler” (benz), me targa AA ***, kur ka qenë në zotërim nga subjekti dhe aktualisht mban targën AA ***.

3.5 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, subjekti ka deklaruar: *kontratë shkëmbimi automjeti me nr. ***, datë 7.2.2015, midis deklarueses dhe shtetasit R. Z., për automjetin “Daimler Crysler” (benz), me targa ***, duke u bërë pronare deklaruesja e autoveturës “Volkswagen” (aktualisht AA ***).*

3.6 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, subjekti ka deklaruar: *kontratë shkëmbimi automjeti nr. ***, datë 20.7.2016 e lidhur midis deklarueses dhe shtetasit D. M. për automjetin “Volkswagen”, me targa ***, duke u bërë pronare deklaruesja e automjetit të tipit “Mercedes-Benz”, ***, viti 2006, ngjyre gri, me targa ***. Vlera: 4.000 euro (referuar vlerës së automjetit të parë të shkëmbyer sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 21.11.2012 (shihni deklaratën. e pasurisë së vitit përkatës).*

- Në lidhje me historikun e blerjes dhe të shkëmbimit të automjeteve

3.7 Gjatë hetimit ka rezultuar se automjeti tip “Daimler Chrysler” është blerë nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 4.000 euro, shtetasit E.R. me kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 20.11.2012. Ky i fundit rezulton ta ketë blerë këtë automjet në datën 25.10.2012, në vlerën 6.000 euro. Shtetasi E. R. ka kryer edhe zhdoganimin e automjetit në datën 29.10.2012, duke paguar në doganë TVSH-në, në vlerën 228.659 lekë. Rezulton se vlera e këtij automjeti pas zhdoganimit duhet të ishte në vlerën 1.069.799 lekë³⁷.

3.8 Komisioni, për shkak të ndryshimeve në çmim, e ka pyetur³⁸ subjektin, e cila, ndër të tjera, ka sqaruar se: “...personalisht për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, prej rreth 19 vjet dhe mos pasjes së asnjë lidhje apo njohje me shitësin as unë dhe as bashkëshorti, nuk mund të hamendësoj për asnjë nga kushtet/rrethanat e shitësit që e kanë çuar/shtyrë të kryejë një shitje të automjetit në këtë vlerë, por meqenëse më kërkohet një interpretim nuk përjashtohet ndonjë aksident e dëmtim i mjetit përgjatë kësaj periudhe nga shitësi, nevoja emergjente e tij për të siguruar të ardhura për ndonjë arsye familjare, shëndetësore të tijën apo të familjarëve, apo nevoja të tjera. Jam e prirur të dyshoj që mjeti mund të ketë pësuar ndonjë aksident para tjetërsimit dhe është riparuar nga shitësi, për faktin që automjeti në kohën e blerjes ka pasur nevojë për shërbime të cilat bashkëshorti ia ka kryer në një servis automjetesh disa ditë pasi është finalizuar kontrata e shitjes. Jemi interesuar ku i kemi bërë shërbimet këtij mjeti pas

³⁷6.000 euro x 140.19 (kursi i këmbimit sipas doganës) + 228.659 lekë (TVSH në doganë).

³⁸ Pyetësor nr. 2, datë 13.9.2021.

blerjes dhe bashkëshorti ka mundur të sigurojë një deklaratë të datës 21.9.2021 nga shtetasi J.R. tek i cili janë blerë nga bashkëshorti disa pjesë këmbimi për këtë automjet, akt shkresor të cilën jua vëmë në dispozicion. Bashkëshorti më ka kujtuar e informuar që këtij automjeti i kemi bërë shërbime/ndërrime pjesësh në një vlerë rreth 130.000 lekë. Ju informoj se shtetasi me gjeneralitetet E. R. nuk ka pasur ndonjë proces gjyqësor³⁹ civil, administrativ apo penal përgjatë gjithë periudhës që unë kam ushtruar funksionin e gjyqtarës, ku unë në cilësinë e magistrates të kem drejtuar këto procese gjyqësore apo gjykuar këtë subjekt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2014–2019 dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për periudhën 2004–2013.

3.8.1 Rezultoi se automjetin tip “Daimler Crysler”, subjekti e ka shkëmbyer me automjetin tip “Volkswagen Phaeton”, me kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 7.2.2015, nga shtetasi R. Z. . Ky i fundit rezultoi ta ketë blerë automjetin tip “Volkswagen Phaeton”, në shumën 1.600 euro. Gjithashtu, rezultoi se auomjeti është zhdoganuar në datën 6.11.2014 duke paguar në doganë TVSh-në, në vlerën 48.882 lekë.

3.8.2 Më pas, subjekti, automjetin tip “Volkswagen Phaeton”, e ka shkëmbyer me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 20.7.2016, nga shtetasi D. M. . Ky i fundit rezultoi ta ketë zhdoganuar automjetin në vlerën 2.000 euro, në datën 20.7.2016, duke paguar në doganë TVSh-në, në vlerën 88.250 lekë.

3.9 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka mbajtur korrespondencë me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në përgjigjet⁴⁰ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë genë shtetasit R.Z. dhe D. M. .

3.10 Për sa më sipër u analizua, trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi këtë pasuri.

3.11 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën e investimit, duke përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e kryera, deri në datën e blerjes së automjetit. Nga analiza e kryer përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet e tjera familjare.

4. Gjendje *cash* në vlerën 90.000 lekë

4.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: *të ardhurat e realizuara mundësojnë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.*

4.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në gjendje *cash* nga deklarata periodike vjetore e vitit 2006 deri në vitin 2016.

4.3 Kursimet në gjendje *cash* për vitin 2016 rezultojnë në shumën 300.000 lekë. Trupi gjykues, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për vitet 2003 – 2016, në të cilën u përfshinë edhe kursimet *cash*, sipas deklaramit periodik të subjektit, nga ku rezultoi se viti 2016 ishte në balancë pozitive. Për pasojë, meqenëse vlera e kursimeve *cash* është më e ulët në deklaratën *Vetting* nga ajo me të cilën është përmyllur viti 2016, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika, ndërsa konkludoi se subjekti ka pasur mundësi financiare në krijimin e tyre. Nga ana tjetër, çmohet se vetëm nëse kursimet *cash* do të ishin në një vlerë më të madhe

³⁹Subjekti ka vendosur në dispozicion edhe vërtetimet respektive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan të datës 14.09.2021.

⁴⁰Shkresë nr*** prot., datë 8.10.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nr. *** prot., datë 28.10.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

se sa ajo e deklaruar në vitin 2016, atëherë do të lindte nevoja e një analize të detajuar mbi mundësinë financiare të shtimit të tyre.

5. Depozitë bankare e bashkëshortit të subjektit, në “Tirana Bank”, datë 17.9.2004, në vlerën 250.000 lekë

5.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁴¹ dokumentin nxjerrje llogarie nga “Tirana Bank”, nga data 1.1.2004 - 31.12.2004, ku figuron gjendja 250.000 lekë, datë 17.9.2004.

5.2 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.*

5.3 Nga korrespondenca e Komisionit me “Tirana Bank”⁴², kjo e fundit konfirmon çeljen e depozitës në shumën 250.000 lekë, në datë 17.9.2004, në emër të bashkëshortit të subjektit, si dhe tërheqjen e saj pas përfitimit të interesave, në datën 17.12.2004. Pra, depozita e deklaruar nga subjekti është një depozitë e vitit 2004, të cilën bashkëshorti i saj nuk e dispononte në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*.

5.4 Trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare në momentin e çeljes së kësaj depozite dhe në tërësi nuk i rezultuan problematika.

5.5 Gjithashtu, nga analiza e kryer rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi të investojnë në depozitë shumën 250.000 lekë, si dhe të përballojnë të gjitha shpenzimet e tjera familjare.

➤ **Detyrime financiare**

6. Kredi në vlerën 32.000 euro, në NBG, dega Tiranë, me afat 15-vjeçar, me interes fillestar 8.9% në vit, me kontratën e kredisë nr. *, datë 20.12.2004, për blerjen e një apartamenti banimi (detajet janë te të dhënat konfidenciale).** Mbetur deri në datën 19.1.2017 detyrimi në shumën 10.525.12 euro. Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin⁴³ justifikues.

6.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: dokumentacioni i dorëzuar konfirmon gjendjen e mbetur në vlerën 10.525 euro, deri në datën 19.1.2017. NBG konfirmon gjendjen e mbetur të kredisë në vlerën 10.267,29 euro lekë, deri në datën 23.1.2017.

6.2 Gjatë hetimit u konstatua se kjo kredi është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2004 me qëllim blerjen e apartamentit. Trupi gjykues ka hetuar dhe arsyetuar lidhur me këtë kredi në pikën 1.4.i – 1.4.vii, në këtë vendimmarrje.

6.3 “ABI Bank” (ish-NBG), me shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2020, ka informuar mbi kredinë në shumën 32.000 euro dhe nga statement rezultoi se detyrimi i mbetur deri në datën 23.1.2017 është në vlerën 10.367,24 euro.

7. Deklaratë noteriale me nr*, datë 31.8.2016, e subjektit deklarues për cilësim të huas aktuale të pashlyer.** Detyrimi është në vlerën 425.000 lekë (*detajet janë te të dhënat konfidenciale*). Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin justifikues⁴⁴.

7.1 Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti ka deklaruar në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, si vijon:

⁴¹Aneks nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2021.

⁴³Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴Aneks nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së.

7.1.i Kontratë huamarrje, nr. ***, datë 29.7.2009, me shtetasin H. K., me huamarrëse deklaruesen, për një shumë prej 1.300.000 lekësh.

7.1.ii Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 31.8.2016, për shlyerjen pjesërisht të huas së mësipërme midis të njëjtave palë dhe përcaktimin e detyrimit të mbetur pa shlyer (shihni mandatarkëtimin, nga NBG, datë 1.9.2016, për shlyerjen e shumës 275.000 lekë). Për shtetasin H. K., shuma e dhënë hua prej 1.3000.000 lekësh është shuma e kursimeve nga puna e tij, e të ardhurave nga aktiviteti tregtar në dyqanin në pronësi të tij të ndodhur në Elbasan, si dhe kursime të familjes së origjinës (bashkëngjitur kësaj deklarate, statement bankare e vërtetimet përkatëse). Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin justifikues⁴⁵.

7.1.iii Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2009, në rubrikën e detyrimeve financiare, ka deklaruar: “Kontratë huaje pa interes me afat deri në shitjen e apartament banimi nr. ***, k. ***, nr. pasurie ***, z. k. *** me shtetasin H. K., me huamarrëse deklaruesen, nr. ***, datë 29.7.2009. Vlera” 1.300.000 lekë”.

7.1.iv Ndër vite, subjekti ka deklaruar shlyerje ndaj huadhënësit H.K. . Në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*, detyrimi i mbetur ishte në vlerën 425.000 lekë. Kjo shumë konfirmohet edhe nga deklarata noteriale nr. ***, datë 31.8.2016, me palë H. K. dhe Tereza Merkaj, të cilët kanë deklaruar se: “... së bashku kanë nënshkruar në këtë zyrë aktin kontratë huaje me nr. ***, datë 29.7.2009, me palë huadhënëse H. K. dhe huamarrëse Tereza Merkaj... I nënshkruari H.K. deklaron se ka marrë jashtë kësaj zyre noteriale nga huamarrësja Tereza Merkaj në disa këste ndër vite shumë 600.000 lekë dhe sot në datën e nënshkrimit ka marrë gjithashtu jashtë kësaj zyre noteriale shumë 275.000 lekë. Deri në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate deklararon se ka marrë në total shumë prej 875.000 lekësh dhe shuma që mbetet për tu likuiduar nga huamarrësja në masën 425.000 lekë do të shlyhet sipas përcaktimeve në kontratën e huas”.

7.1.v Gjatë hetimit rezultoi se edhe ky detyrim i mbetur është shlyer në datën 24.4.2018 nga llogaria e bashkëshortit të subjektit E.M., në “Tirana Bank”, në vlerën 3.355 euro ose 425.000 lekë.

7.1.vi Lidhur me shlyerjet e kryera, ndër vite, për këtë hua, trupit gjykues nga analiza financiare e kryer përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, nuk i kanë rezultuar problematika.

7.2 Për sa më sipër analizuar edhe në harmoni me dokumentacionin e administruar, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet.

8. Kredi bankare (*overdraft*) marrë nga bashkëshorti i subjektit, në vlerën prej 150.000 lekë, në “Tiranës Bank”, për një afat prej 1-vjeçar, me interes 9.7% në vit, me kontratën e kredisë, datë 31.12.2016. Detyrimi financiar në vlerën 150.000 lekë. Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin justifikues⁴⁶.

8.1 “Tirana Bank”, me shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2021, ka konfirmuar llogari të lidhur me *overdraft* në emër të shtetasit E. M. (bashkëshorti i subjektit) me gjendje në datën 23.1.2017, në shumë -149.814,07 lekë.

Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konkludon se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

➤ **Deklarime të subjektit në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”**

9. Kredi e marrë nga subjekti deklarues, nëna e subjektit (T. K.) dhe bashkëshorti në vlerën 32.000 euro, në NBG, dega Tiranë, për një afat prej 15 vjetësh, me interes fillestar

⁴⁵Aneks nr. 4/7 dhe nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁶Aneks nr. 4/8, në dosjen e ILDKPKI-së.

8.9% në vit, me kontratën e kredisë nr***, datë 20.12.2004, për blerjen e apartamentit 1+1, me sip. 65.85 m² (me sip. 57.40 m² të rivlerësuar), të ndodhur në rruga “****”, Tiranë, 1/1- shtesë e kontratës së kredisë, datë 16.12.2015, për ndryshimin e interesit të kredisë në 8% në vit për kredinë e sipërcituar. Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin justifikues⁴⁷.

- Nga hetimi u vërejt se këtë kredi subjekti e ka deklaruar edhe në rubrikën e detyrimeve financiare. Trupi gjykues, hetimin e kryer lidhur me këtë kredi dhe njëkohësisht edhe konkluzionin e saj, i ka përshkruar më sipër në këtë vendimmarrje.

10. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë së paluajtshme aktuale, apartament 2+1, me sip. 88.82 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, ap. ****, rruga “****”, Tiranë, subjekti ka sqaruar se: “Rreth një vit e gjysmën më pas, nga shitja e një tjetër apartamenti me sipërfaqe 51.25 m², në bashkëpronësinë tonë të ndodhur në Tiranë (shitur⁴⁸ me kontratën nr. ***, datë 6.12.2012, në shumën prej 5.500.000 lekë, sipas deklarimeve të pasurisë ndër vite), në datë 7.12.2012, bashkëshorti im E. M. i ka kthyer shtetasit A.P. shumën e huas bashkë me interesat në vlerën totale prej 5.425.000 lekësh, e vërtetuar kjo me deklaratë të thjeshte dore, datë 7.12.2012 (huaja që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 88.82 m², në Tiranë, në vlerën prej 5.000.000 lekë me interes 6% në vit e marrë nga bashkëshorti im E.M. këtij shtetasi e vërtetuar kjo po me deklaratë huaje të datës 14.7.2011). Për shtetasin A. P. (lidhje shoqërore e bashkëshortit) shuma e dhënë hua prej tij respektivisht, si më sipër është evidentuar, janë të ardhura të fituara nga aktivitetet tregtare, bizneset e familjes së tij, kursimet ndër vite (dokumentet vërtetuese të burimit të tij të të ardhurave bashkangjitur kësaj deklarate)”. Shihni edhe deklaratat e pasurisë ndër vite. Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin justifikues⁴⁹.**

- Trupi gjykues lidhur me këtë çështje, vlerëson të mos bjerë në përsëritje, nisur nga fakti se i gjithë burimi i kësaj pasurie është pikërisht shuma 5.000.000 lekë e marrë hua nga shtetasi A.P., hua e cila është hetuar dhe analizuar gjerësisht në pikën nr. 2 të kësaj vendimmarrje.

➤ Gjetje të tjera - Pasuri të krijuara dhe të tjetërsuara gjatë periudhës së deklaramit

Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në këtë rubrikë të gjitha investimet e kryera në pasuri, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, gjatë periudhës së deklaramit, pavarësisht se ato janë tjetërsuar dhe nuk zotërohen më në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*. Kjo për faktin se, për sa kohë pasuritë e tjetërsuara, gjithashtu, kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë aktuale, apo edhe për faktin se subjekti ka hyrë edhe në marrëdhënie huamarrje për krijimin e tyre, trupi gjykues vlerësoi të arsyetojë dhe të konkludojë në këtë vendimmarrje edhe hetimin e thelluar të kryer për këto pasuri.

11. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2007 ka deklaruar: “Blerë apartament, garsoniere me sipërfaqe 34 m² me adresë Durrës, lagjja *, Plazh, Kati ***, z. k. ***, me nr. pasurie ***, në bashkëpronësi në pjesë të barabarta të deklarueses dhe bashkëshortit, me nr. ***, datë 25.10.2007. Çmimi i blerjes: 1.100.000 lekë”.**

⁴⁷Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁸Çmimi i shitjes nuk ka kaluar nga llogaria e noterit për shkak të hyrjes në fuqi të udhëzimit të përbashkët midis MD dhe MF nr. ***, datë 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”, në datën 31.12.2012 (me botimin e aktit në këtë datë në fletoren zyrtare), që do të thotë se prej kësaj date ai shtriu efektet e zbatimit të tij

⁴⁹Aneks nr. 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

Po në këtë deklaratë, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: “Kontratë huamarrje pa interes dhe pa afat për shumën 1.000.000 lekë, me personin fizik shtetasin S.M., me huamarrës bashkëshortin, me nr. kontrate ***, datë 24.10.2007”.

Faktet e rezultuara nga hetimi

11.1 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit nëpërmjet Drejtorisë Vendore Durrës⁵⁰ ka informuar se nga verifikimi i sistemit dixhital i të dhënave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës, rezulton se:

- Pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë apartament, pas disa tjetërimeve ka kaluar me kontratë shitje nga shtetasit Tereza Merkaj dhe E. M. tek G.A. dhe B. A. . Kjo drejtori ka bashkëlidhur si dokumentacion:

- Kontratë shitje apartamenti, nr. ***, datë 25.10.2007, me palë shitëse E. S. (përfaqësuar me prokurë të posaçme) dhe palë blerëse E. dhe Tereza Merkaj, të apartamentit me sipërfaqe 34 m², të ndodhur në Durrës, lagja ***, Plazh, k. ***, sh. ***, ap. ***, z. k. ***, pasuria me nr. ***. Çmimi i shitjes 1.100.000 lekë, shumë e cila është likuiduar plotësisht nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

- Vërtetim hipotekor nr***, datë 19.12.2007.

- Kontratë shitje apartamenti, nr. ***, datë 12.9.2009, me palë shitëse E. dhe Tereza Merkaj dhe palë blerëse G. A. dhe B. A., të apartamentit me sip. 34 m², të ndodhur në Durrës, lagja ***, Plazh, k. ***, sh. ***, ap. ***, z. k. ***, pasuria me nr***. Çmimi i shitjes 2.400.000 lekë, shumë e cila është likuiduar plotësisht nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 16.9.2009, ku rezulton se shtetasja Tereza Merkaj ka paguar shumën 130.000 lekë, tatim.

11.2 Gjatë hetimit administrativ, subjekti në pyetësorin nr. 1 ka deklaruar se: “Burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer huaja e marrë në vlerën prej 1.000.000 lekësh nga ana e bashkëshortit, babait të tij, shtetasit S.M. në datën 22.10.2007, e vërtetuar kjo me kontratën⁵¹ e huas nr. ***, datë 24.10.2007 dhe pjesa e mbetur prej 100.000 lekësh është plotësuar nga pagat tona”.

11.3 Në mbështetje të deklaramit, subjekti ka depozituar edhe kontratën e huas nr. ***, datë 24.10.2007, ku huadhënësi shtetasi S.M. deklaroi se i ka dhënë në datën 22.10.2007, shumën 1.000.000 lekë, huamarrësit E. M. .

11.4 Subjekti ka sqaruar se: “Për shtetasin S.M. (babai i bashkëshortit) shuma e dhënë hua prej 1.000.000 lekësh është shumë e kursimeve familjare nga puna e tij dhe e bashkëshortes së tij, ndër vite⁵².”

11.5 Komisioni i kërkoi⁵³ subjektit të depozitonte dokumentacion justifikues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua prej 1.000.000 lekësh, nga shtetasi S.M. .

11.6 Subjekti depozitoi shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2021, të ISSH-së, si dhe dokumentacionin mbështetës për punësimin e prindërve të bashkëshortit.

11.7 Komisioni hetoi, gjithashtu, edhe lidhur me ekzistencën e pasurive në emër të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

⁵⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2020.

⁵¹Kjo kontratë është depozituar nga subjekti edhe në ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur me këtë të fundit.

⁵²Shihni aktet provuese si kopje librezës së punës së vjehrrit etj. të depozituara me deklaratën *Vetting*.

⁵³Me pyetësor nr. 2, datë 13.9.2021.

11.7.1 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁵⁴ informoi se në emër të shtetasit S. N. M., figuron e regjistruar pasuria: apartament me sip. 93.18 m², z. k. *** vol. ***, f. ***.

11.7.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezultoi se ky apartament vjen si pasojë e transaksionit, bashkim pasurish. Më konkretisht u vërejt se kjo pasuri vjen si pasojë e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 3.10.1996, ku shtetasi S. M. rezulton të ketë blerë apartamentin me sip. 50 m², në vlerën 1.200.000 lekë dhe sip. 43.18 m² (legalizuar me lejen nr. ***, datë 20.4.2012), sipas vërtetimit hipotekor 14.6.2012.

11.8 Komisioni vlerësoi, që përlllogaritjet mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi për vjehrrin e subjektit S. M., të kryehen prej vitit 2001. Ndërsa u vërejt se vjehrra e subjektit Z.M. figuron në pension që prej muajit maj të vitit 2002. Analiza financiare është kryer vetëm me të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës (pasi nuk janë identifikuar investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme), nga ku ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit të subjektit mund të kursenin shumën 1.196.383 lekë.

11.9 Nga analiza e kryer, konfirmohet se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare për të dhënë huan, në shumën 1.000.000 lekë.

11.10 Trupi gjykues, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare në datën e investimit në pasurinë “apartament”, objekt i këtij hetimi administrativ, duke marrë në këtë rast në konsideratë edhe huan, burimi i të cilës rezultoi i ligjshëm sipas nenit D/3, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe duke përfshirë çdo të ardhur dhe shpenzim tjetër të identifikuar.

11.11 Nga analiza e kryer dhe verifikimi i dokumentacionit mbështetës në tërësi, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

11.12 Komisioni hetoi edhe në lidhje me gjendjen e *konfliktit të interesit* të subjektit të rivlerësimit në raport me shitësit e kësaj pasurie. Në këtë drejtim është mbajtur korrespondencë me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në përgjigjet⁵⁵ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, ku palë në proces me çfarëdo statusi të kishte qenë shtetasi E.S. (shitësi i apartamentit).

11.13 Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

11.14 Në vijim, Komisioni hetoi edhe lidhur me ndonjë *trajtim preferencial* të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie. Paraprakisht u vlerësua të konsiderohet si referencë legjislacioni i kohës, më konkretisht udhëzimi nr. 2, datë 4.4.2007, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2007. Sipas këtij udhëzimi, rezultoi se vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2007, për qytetin e Durrësit, ka qenë 81.080 lekë/m².

11.15 Në rastin objekt hetimi, apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj është me sip. 34 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezultoi se vlera e apartamentit është 2.756.720 lekë. Nga përlllogaritjet u konkudua se kjo vlerë është më e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 1.100.000 lekë, pra, 1.656.720 lekë (2.756.720 - 1.100.100 lekë) më lirë nga çmimet e tregut.

11.16 Mbi këtë konstatim, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

⁵⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020.

⁵⁵Shkresë nr*** prot., datë 8.10.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

11.17 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, lidhur me paqartësinë mbi shkakun/motivin apo faktor tjetër ndikues në përcaktimin e çmimit të blerjes në shumën 1.100.000 lekë në vitin 2007, të pasurisë së paluajtshme garsoniere, me nr. pasurie ***, apartament me sip. 34 m², e ndodhur në lagjen ***, Durrës, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 25.10.2007, ka sqaruar se kontrata e shitblerjes për sa kujton është lidhur me palën ndërtuese apo familjarë të saj dhe njëherazi përfituese të disa njësive të banimit në këtë pallat dhe apartamentit në fjalë me një sipërfaqe krejt modeste (garsonierë), e përdorur për një kohë të konsiderueshme prej disa vitesh nga vetë ndërtuesit dhe familjet e tyre që prej përfundimit të ndërtimit deri në kalimin e pronësisë tek subjekti dhe bashkëshorti. Subjekti, lidhur me çmimin e vendosur dhe dakordësuar me shitësit në kontratën e shitjes së kësaj pasurie ka cituar se: *“Mund të them që ky çmim është vendosur plotësisht në bazë të udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht duke konsideruar tabelën e parë me referencat për kostot mesatare të ndërtimit ku Durrësi ka pasur çmimin 25.141 lekë/m². Vlera e apartamentit sipas këtij çmimi arrin në shumën prej 8.547.94 lekësh, ndërsa ne e kemi blerë në vlerën 1.100.000 lekë. Po ashtu kjo kontratë është tërësisht e rregullt si nga pikëpamja formale (e përpiluar me akt noterial) ashtu edhe në drejtim të elementëve të saj lidhur me përmbajtjen. Qëllimi i shitësve ishte tjetërsimi i saj, ndërsa qëllimi ynë ishte fitimi i pronësisë së saj duke paguar çmimin e vendosur nga shitësit. Si unë ashtu edhe bashkëshorti im kur kemi dakordësuar për blerjen e kësaj pasurie dhe kemi kryer këtë veprim juridik, e kemi bërë sepse çmimi na është dukur i volitshëm dhe i përballueshëm, e ndaj nuk kemi patur asnjë dyshim, arsye apo detyrim ligjor të hetojmë për qëllimet e shitësve lidhur me arsyet e shitjes në këtë vlerë të kësaj pasurie (edhe pse e kanë realizuar fitimin e tyre në këtë çmim), pasi në çdo marrëdhënie kontraktuale shitblerjeje qoftë pasuri e luajtshme apo e paluajtshme, qëllimi i secilës palë është të përmbushë interesat e saj pasurorë në respektim të ligjit në këtë transaksion. Në mungesë të plotë të ndonjë lidhje apo njohje tonën me shitësit (pasi këtë pasuri e ka identifikuar vjehri nga gazeta ‘***’, në atë periudhë) as unë dhe as bashkëshorti, nuk mund të hamendësojmë për asnjë nga kushtet/rrethanat e shitësit që i kanë çuar/shtyrë të kryejnë një shitje të kësaj garsoniere në këtë vlerë, por për sa mbajmë mend, besoj se fakti që ata dhe familjarë të tyre ishin vetë ndërtuesit e Pallatit apo me shumë mundësi dhe pronarë të tokës ku është ndërtuar, përfitimet e realizuara nga shitjet e apartamenteve të këtij pallati mund të kenë përmbushur pritshmëritë e tyre në të ardhurat e synuara dhe të realizuara. Nuk përjashtojmë as ndonjë nevojë tjetër të mundshme të shitësve për të mbledhur sa më shpejt të ardhura për të riinvestuar në ndërtime të tjera prej tyre, apo ndonjë arsye familjare, apo nevoja të tjera”.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

11.18 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, vëren se subjekti nuk ka anashkaluar udhëzimin referues mbi të cilin edhe është konkluduar se pasuria është blerë më lirë se çmimet referente në kohën e ndodhjes së veprimit noterial, por ka synuar të argumentojë disa momente të cilat sipas subjektit duhen konsideruar.

11.19 Trupi gjykues i gjen bindëse argumentet e prezantuar nga subjekti se shitësit duke qenë pronarë të truallit dhe përfitues të disa apartamenteve dhe garazheve dhe, për më tepër, duke qenë se këtë apartament e kanë përdorur ata vetë më parë, kanë qenë tërësisht në kushte të vullnetshme për të shitur pasurinë në vlerën që vetë ata kanë menduar, siç mund të ketë qenë ajo që i përket kostos mesatare të ndërtimit në këtë qytet dhe jo në vlerën e tregut. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë subjekti nuk u gjend në kushte të konfliktit të interesit me shitësin e pasurisë, atëherë në këtë rast duket se thjesht dhe vetëm në përcaktimin e vlerës së shitjes së pasurisë, ka konkurruar raporti i vullnetshëm i krijuar mes palëve në këtë marrëdhënie kontraktore, i cili nuk rezultoi i kontestuar.

11.20 Në tërësi të këtij arsytimi, trupi gjykues krijon bindjen se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi krijimin dhe burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

➤ **Në lidhje me shlyerjen e huas marrë shtetasit S.M. (vjehri i subjektit të rivlerësimit)**

11.21 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2015, deklaroi në rubrikën e detyrimeve financiare, deklaratë noteriale nr. ***, datë 09.12.2015, e shtetasit S.M., në vijim të kontratës së huamarrjes për shumën 1.000.000 lekë midis shtetasit S.M. dhe bashkëshortit me nr. kontrate ***, datë 24.10.2007. Në këtë deklaratë shtetasi S. M. deklaroi se *pjesën e mbetur prej 770.000 lekësh, jua fal mbesave të tij, D. dhe G. M.* . Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar edhe deklaratën noteriale⁵⁶.

- Trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare, lidhur me aftësinë paguese të subjektit dhe bashkëshortit të saj për pjesën e mbetur të huas, duke konsideruar në këtë rast vullnetin e shprehur të huadhënësit për faljen e një pjesë të huas mbesave të tij dhe në tërësi rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të shlyejë huan e mbetur.

12. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2008, deklaroi blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, me nr. kontrate *, datë 19.10.2008, Shijak. Burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “Ford” + gjendje *cash*. Vlera: 300.000 lekë. Gjithashtu, po në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Ford”, me nr. kontratë ***, datë 31.8.2008, në vlerën 250.000 lekë.**

12.1 Subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI⁵⁷, ka depozituar kontratën e blerjes së automjetit nr. ***, datë 19.10.2008, me palë shitëse I.D. dhe palë blerëse Tereza Merkaj, si dhe kontratën e shitjes së automjetit tip “Ford” nr. ***, datë 31.8.2008, me palë shitëse Tereza Merkaj dhe palë blerëse E.D. .

12.2 Trupi gjykues, pasi kreu përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare në datën e investimit në këtë pasuri, nuk i rezultuan problematika.

13. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2009, deklaroi blerje apartamenti me sip. 51.25 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, me adresë: rruga “****”, p****, shk. ***, ap. ***, Tiranë, në bashkëpronësi në pjesë të barabarta të deklarueses me bashkëshortin, me nr****, datë 31.7.2009. Çmimi i blerjes: 3.971.875 lekë. Ndërsa, në rubrikën e detyrimeve financiare deklaroi:**

- Kontratë huaje pa interes, nr. ***, datë 29.7.2009, me afat deri në shitjen e apartamentit të banimit nr. ***, kati ***, me nr. pasurie ***, z. k. ***, me shtetasin H. K., me huamarrëse deklaruesen. Vlera: 1.300.000 lekë.

- Deklaratë huamarrjeje, datë 29.7.2009, me shtetasin A. P. me bashkëshortin. Vlera: 2.400.000 lekë.

- Deklaratë kthim huaje, datë 17.9.2009, shtetasit A.P. nga bashkëshorti.

Faktet e rezultuara nga hetimi

13.1 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Tirana Veri⁵⁸, informon se nga verifikimi në sistemin elektronik digjital IPS, sipas rubrikave “Mbi të dhënat tekst”, si dhe “Mbi dokumentet e arkivës”, pranë kësaj drejtorie, rezultoi se në emër të shtetasve të sipërpërmendur nuk figurojnë pasuri. Bashkëlidhur shkresës, kjo drejtori ka depozituar dokumentacion lidhur me pasurinë apartament, me sip. 51.25 m², e

⁵⁶Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁷Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2020, nga ILDKPKI-ja.

⁵⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020.

cila është blerë dhe shitur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj sipas kontratave të mëposhtme:

- Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 31.7.2009, me palë shitëse S. A. dhe palë blerëse E. dhe Tereza Merkaj, të apartamentit me sip. 51.25 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Çmimi i shitblerjes: 3.971.875 lekë.

- Kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme (apartament) nr***, datë 6.12.2012, me palë shitëse E. dhe Tereza Merkaj dhe palë blerëse Z.Gj., të apartamentit me sip. 51.25 m², të ndodhur, në rrugën “****”, Tiranë, i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. regj. hipotekor ***, datë 1.10.2009, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Çmimi i shitjes: 5.500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës së noterit në formën *cash* (në dorë).

13.2 Në pyetësin nr. 1, subjekti deklaron se burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer: (i) huaja e marrë, datë 29.7.2009, në vlerën 2.400.000 lekë nga ana e bashkëshortit shtetasit A. P. (lidhje shoqërore), e vërtetuar me deklaratë të thjeshte dore, datë 29.7.2009; (ii) pjesa e mbetur është plotësuar nga huaja tjetër e marrë prej subjektit vëllait të saj H. K., në shumën 1.300.000 lekë, me kontratën e huas nr. ***, datë 29.7.2009; si dhe (iii) nga të ardhurat vjetore të bashkëshortëve.

13.3 Komisioni i kërkoi⁵⁹ subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua prej 2.400.000 lekësh nga shtetasi A.P., si dhe huan në shumën 1.300.000 lekë nga shtetasi H. K. .

i) Lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 2.400.000 lekë nga shtetasi A. P., trupi gjykues e ka përshkruar hetimin dhe analizimin e kësaj huaje në pikat 2.6.vii – 2.6.ix në këtë vendimmarrje, ku janë pasqyruar edhe të dhënat financiare.

ii) Ndërsa, për huan në shumën 1.300.000 lekë marrë nga shtetasi H. K., subjekti, në pyetësin nr. 1, deklaron se: *“Për shtetasin H.K. shuma e dhënë hua prej 1.300.000 lekësh është shumë e kursimeve nga puna e tij, e të ardhurave nga aktiviteti tregtar në dyqanin në pronësi të tij të ndodhur në Elbasan dhe e kursimeve të familjes sime të origjinës”*. Subjekti ka depozituar: (a) *statement* bankar në emër të vëllait H. K. dhe nënës T. K., ku pasqyrohen pagat e marra; si dhe (b) vërtetimet përkatëse të punësimit të tyre ndër vite.

iii) Me pyetësin nr. 2, subjekti ka depozituar: (a) shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2021, nga DRT Elbasan, lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti “kinkalери” nga shtetasi A.K., me NIPT ***; (b) deklaratë nr. ***, datë 8.12.2003, për shitjen e pasurisë (njësi) me sip. 34.67 m², në vlerën 4.800.000 lekë nga shtetasi A. K. dhe bashkëpronarët M. K. dhe R.K. . Subjekti deklaron që e gjithë shuma e përfituar nga shitja është marrë prej shtetasit A. K. (njerku); (c) shkresë nr. *** prot., datë 10.9.2021, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Elbasan, për shtetasen T.K.; shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2021, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Elbasan, për shtetasin A. K. .

13.4 Komisioni analizoi dokumentacionin e depozituar dhe i rezultoi se:

- Të ardhurat e përfituara nga shtetasja T. K. (nëna e subjektit) për periudhën 2000 – qershor 2009 janë në shumën 3.329.305 lekë.

- Të ardhurat e përfituara nga shtetasi A.K. (njerku i subjektit) për periudhën 2005 – qershor 2009 janë në shumën 626.725 lekë.

- Të ardhurat e përfituara nga shtetasi H. K. (vëllai i subjektit) për periudhën gusht 2008 – qershor 2009 janë në shumën 330.000 lekë.

- Pjesa takuese nga të ardhurat nga shitja e pasurisë (njësi) me sip. 34.67 m² për shtetasin A. K. është në vlerën 1.600.000 lekë.

⁵⁹Me pyetësin nr. 2, datë 13.9.2021.

- Të ardhurat e përfituara nga aktiviteti “kinkalери” në emër të shtetasit A. K. nuk konfirmohen në vlera të sakta, pasi nuk ka dokumentacion. Nga informacioni i përcjellë rezulton të jetë deklaruar xhiro për vitin 1998 në shumën 2.000.000 lekë dhe është paguar tatim fiks në shumën 33.500 lekë.

13.5 Komisioni kreu analizën për të parë mundësinë financiare të familjes së origjinës së subjektit të rivlerësimit për të dhënë huan në shumën 1.300.000 lekë. Në analizën e kryer, Komisioni vlerësoi të përfshijë të ardhurat e përfituara nga punësimi për familjarët, si dhe pjesën takuese prej 1/3 të përfituar nga shitja e pasurisë së paluajtshme. Meqenëse DRT-ja Elbasan nuk dispononte informacion dhe dokumentacion për shumën e saktë të përfituar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar në emër të njerikut për vitet 1993 - 2009, Komisioni ka vlerësuar që këto të ardhura të mos përfshihen në analizën e kryer. Komisioni nuk e mohon përfitimin e tyre, por meqenëse nuk ka një vlerë të saktë, nuk mund të hamendësojë për shumën e përfituar.

Në pamundësi objektive për të pasur të dhëna financiare mbi aktivitetin tregtar dhe duke përdorur si *indicie* xhiron prej 2.000.000 lekësh në vitin 1998, është konsideruar që të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i këtij aktiviteti mund të kenë shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2002 në vlerën 2.600.000 lekë⁶⁰.

13.6 Trupi gjykues kreu, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare, duke përllogaritur vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës nga viti 2000 deri qershor 2009 kur është dhënë huaja dhe në përfundim i rezultoi se vëllai dhe prindërit e subjektit të rivlerësimit kishin pasur mundësi të kursenin shumën 1.571.753 lekë, që, për pasojë, rezultoi se kanë pasur mundësi financiare të jepnin hua shumën 1.300.000 lekë.

13.7 Pas kësaj analize, trupi gjykues kreu analizën financiare deri në datën e investimit në pasurinë apartament, duke e marrë në konsideratë huan, pasi u provua burimi i ligjshëm i krijimit të saj, si dhe çdo të ardhur dhe shpenzim tjetër të identifikuar, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

➤ **Në lidhje me shlyerjet e huave të marra për këtë pasuri**

13.8 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti deklaroi shitjen e apartamentit garsoniere, me sip. 34 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë: Lagjja ***, plazh, kati i ***, Durrës, në bashkëpronësi ne pjesë të barabarta të deklaruases dhe bashkëshortit, me nr. ***, datë 12.9.2009, në vlerën 2.400.000 lekë. Gjithashtu, subjekti deklaroi kthim huaje, datë 17.9.2009, shtetasit A. P. nga bashkëshorti. Shitja e kësaj pasurie konfirmohet nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës⁶¹. Kjo drejtori ka depozituar kontratën e shitjes së pasurisë dhe mandatin e pagesës⁶² së tatimit për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, në emër të znj. Tereza Merkaj.

13.9 Lidhur me këtë shitje, pas analizimit të dokumentacionit, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika. Kontrata e shitjes, e hartuar pranë noterit, për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara, rezultoi konform legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, të cilët janë likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale, si dhe është regjistruar në hipotekë në favor të blerësit.

⁶⁰Kontratë sipërmarrjeje, datë 21.12.2002; kontratë shitjeje nr. ***, datë 25.8.2005, depozituar nga subjekti në pyetësozin nr. 1, datë 22.7.2020.

⁶¹Me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2020.

⁶²Sipas legjislacionit të kohës, tatimi i paguar rezulton në vlerën 130.000 lekë (10% e diferencës 2.400.000-1.100.000 lekë).

13.10 Së bashku me deklaratën *Vetting*, në ILDKPKI ndër vite, por edhe gjatë hetimit, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 17.9.2009, ku shtetasi A. P. deklaroi se më 17.9.2009 ka marrë nga shtetasi E.M. shumën 2.400.000 lekë, të cilën ia ka dhënë hua që prej datës 29.7.2009.

13.11 Trupi gjykues, pasi kreu përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare për vitin 2009 dhe konsideroi deklarin e vullnetshëm mes palëve në kohë reale se kjo hua ishte shlyer në vitin 2009, nuk konkludoi në problematika për shlyerjen e saj. Gjithashtu, trupi gjykues konkludon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi shlyerjen e kësaj huaje.

14. Gjatë hetimit, nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 2⁶³ ka informuar se në emër të shtetasit E. S. M. figurojnë të regjistruara:

- pasuria e llojit “arë”, me sip. 195 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***;
- pasuria e llojit “arë”, me sip. 1805 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***;
- pasuria e llojit “arë”, me sip. 440 m², z. k.***, vol. ***, f. ***.

Sipas kartelave të pasurisë bashkëlidhur shkresës së dërguar rezultojnë se:

- pasuria arë, me sip. 195 m² është blerë në shumën 150.000 lekë;
- pasuria arë, me sip. 1805 m² është blerë në shumën 950.000 lekë;
- pasuria arë, me si. 440 m² është blerë në shumën 200.000 lekë.

14.1 Gjithashtu, nga verifikimi i regjistrimit noterial⁶⁴, u evidentuan të dhëna për kontrata të lidhura pranë noterit publik, për të cilat Komisioni i kërkoi⁶⁵ subjektit që t'i depozitonte.

14.2 Subjekti, në përgjigje depozitoi kontratat e kërkuara, të cilat, pas verifikimit, u vërejt se korrespondonin me blerjet e pasurive të llojit “arë”, të sipërcituara. Këto pasuri rezultojnë të jenë blerë në gusht të vitit 2020, pas shitjes së apartamentit me sip. 57.4 m², të përshkruar në pikën nr. 1 në këtë vendimmarrje.

15. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte kryer disa transaksione bankare në NBG Bank (sot ABI Bank), përkatësisht, në datën 4.12.2002 kishte depozituar shumën 10.000 USD, të cilën më pas e kishte tërhequr, si dhe në datën 12.12.2002 kishte depozituar shumën 19.000 euro, shumë e cila ishte tërhequr: (i) në datën 20 dhjetor në shumën 8.000 euro; dhe (ii) në datën 24.12.2003 në shumën 11.001,86 euro. Pavarësisht se Komisioni konstatoi se lëvizjet bankare janë kryer përpara se subjekti të ishte objekt deklarimi, i kërkoi të japë shpjegime lidhur me këto transaksione, si dhe lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të tyre/shumave.

15.1 Subjekti, në përgjigjen e dhënë⁶⁶, ka sqaruar se në kohën e kryerjes së lëvizjeve bankare ndiqte Shkollën e Magjistraturës. Në vijim, ka synuar të sqarojë një pjesë të historikut të jetës së saj, duke qartësuar se deri në moshën 10-vjeçare ishte rritur kryesisht me gjyshërit e saj, pasi i ati kishte ndërruar jetë që kur kishte qenë 3-muajshe dhe se më së shumti shkonte tek xhaxhai i saj G. L., i cili ishte kujdesur më së shumti për të, duke e ndihmuar edhe financiarisht.

Subjekti ka sqaruar se tashmë ai kishte ndërruar jetë, por kryesisht, prej vitit 1992 kishte jetuar në shtetin grek. Ndërsa ka qenë i sëmure dhe ka dashur të takojë mbesën e tij, subjekti ka sqaruar se gjithashtu ka dashur të udhëtojë për ta parë dhe takuar xhaxhain nga afër. Në kushte të tilla i është gjendur në ndihmë familja e saj e origjinës, njerku, i cili e ka ndihmuar financiarisht për të mundësuar shumën e kërkuar si garanci bankare me qëllim marrjen e vizës për të udhëtuar në shtetin grek.

⁶³Me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2020.

⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

⁶⁵Pyetësor nr. 2, datë 13.9.2021.

⁶⁶Dërguar me nr. *** prot., datë 14.12.2021.

Subjekti ka sqaruar se formulari që duhej plotësuar për marrjen e vizës, ndër të tjera si garanci, kërkonte edhe një pagë relativisht të lartë, për të cilën shprehet se ishte ende studente dhe nuk e dispononte një të tillë. Subjekti ka sqaruar se pasi i janë dhënë 10.000 USD ka marrë informacion se duhej një shumë më e lartë dhe në monedhën euro, e në kushte të tilla, e ka tërhequr shumën 10.000 USD, duke e shtuar përsëri me një tjetër shumë të dhënë po nga njerku, të cilën e ka finalizuar plotësisht në euro dhe depozituar në bankë. Subjekti ka sqaruar se është pajisur me vizë dhe se me tërheqjen e shumës për t'ia kthyer njerkut të saj, për të bërë bindës veprimet bankare, ka shpjeguar se pikërisht pasi ka tërhequr shumën 8.000 euro në të njëjtën datë, 20.12.2021, njerku i saj ka paguar edhe këstin prej 8.000 euro të një apartamenti të porositur sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 21.12.2002.

Subjekti ka deklaruar edhe lidhur me burimin e krijimit të shumave, duke vijuar të sqarojë se janë krijuar si rezultat i ushtrimit të biznesit të vogël të njerkut të saj që prej vitit 1993 deri në vitin 2009.

Subjekti ka depozituar shkresën e DRT-së Elbasan për të provuar ushtrimin e biznesit të vogël në emër të njerkut A.K., certifikatën e vdekjes së të ndjerit, xhaxhait të saj, fotografi për të cilat ka shpjeguar se ka dalë tek xhaxhai në shtetit grek në kohën kur udhëtoi për ta vizituar, si dhe një artikull lidhur me liberalizimin e vizave.

15.2 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson se për faktet dhe rrethanat e rezultuara në vijim, subjekti ka shpjeguar bindshëm veprimet bankare të kryera në kohën kur ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës, duke deklaruar kështu me vërtetësi e saktësi lidhur me to.

Konkludimi më sipër është rezultat i faktit që: (i) subjekti, në kohën e kryerjes së transaksioneve, ka qenë studente dhe jo në marrëdhënie pune; (ii) përgjatë hetimit në tërësi të rivlerësimit të subjektit është trajtuar situata financiare e familjes së origjinës së subjektit, përfshirë edhe të ardhura e krijuara nga aktiviteti i ushtruar nga njerku i saj; (iii) përgjithësisht, në trajtimin e pasurive në këtë vendimmarrje rezultoi se familja e origjinës⁶⁷ së subjektit kishte pasur të ardhura për ta ndihmuar me huadhënie; (iv) shuma 8.000 euro e tërhequr nga subjekti korrespondon ekzaktësisht me shumën e dhënë në favor të porosisë së apartamentit nga familja e origjinës; si dhe (v) në kohën kur kanë ndodhur veprimet vizat e udhëtimit jashtë vendit ende nuk ishin liberalizuar dhe se për përfitimin e tyre padyshim kërkoheshin garanci të ndryshme.

B. KONTROLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin mbi kontrollin e figurës nr. ***, datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.7.2021, të KDZH-së, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Tereza Merkaj.

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

⁶⁷Analizuar mundësia financiare e tyre në pikën 13 të kësaj vendimmarrjeje.

Nga hetimi⁶⁸ i kryer nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit Tereza Merkaj arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaratime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve nga raporti i vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga grupi përkatës i punës, i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ⁶⁹. Në përfundim të trajtimit të secilit grup të burimeve të informacionit, raporti ka konkluduar për secilin komponent si vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ajo i kushton rëndësi të gjithë elementeve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal, duke treguar njohuri edhe për alternativat e dënimit me burgim. Në disa raste përdor referenca në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, si dhe përdor ligjet specifike, si ligji “Për të drejtat e trajtimit të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, apo konventat “Për

⁶⁸Pas përgjigjes nr. *** prot., datë 5.10.2021, mbi përditësimin e raportit.

⁶⁹Sipas të dhënave nga data baza e ankesave rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Tereza Lani (Merkaj) janë paraqitur gjithsej 11 ankesa (1 e vitit 2014, 2 të vitit 2015, 8 të vitit 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së. 2 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se (1 e vitit 2014) zgjidhet përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta (1 e vitit 2015), arkivuar pasi nuk ka rrethana dhe fakte të vlefshme për verifikim. Në lidhje me ankesat e verifikuara rezultatet renditen si vijon: 1 ankesë e vitit 2015 (mbetur në proces verifikimi) me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni, me shkresën përcjellëse nr. ***prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. *** prot., datë 28.7.2020. Ndërsa 8 ankesa të vitit 2016 (të njëjtit ankesa të përsëritura është propozuar bashkimi me ankesën e vitit 2015, 3 nga këto ankesa janë dorëzuar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë).

transferimin e procedimeve në çështjet penale” e “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale”. Ajo ka njohuri për parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i përdor ato në procedurën e gjyimit, gjithashtu sipas rastit, i analizon shprehimisht në tekstin e vendimit, siç është parimi i mosgjyimit dy herë për të njëjtin fakt penal, parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit në rigjykim, zbatimit të dispozitës më favorizuese etj. Tri dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën penale, ku kombinon mirë rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjithashtu ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale lidhur me rregullat e aplikimit të gjyimit të shkurtuar, kundërshtimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, apo njohjen e vendimit penal të huaj. Ndër 5 dosjet e vëzhguara është ankimuar 1 vendim gjyqësor përfundimtar dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa ndaj 4 vendimeve nuk është ushtruar ankim. Lidhur me vendimin e ankimuar, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Për sa i përket 3 dokumenteve ligjore nga aktet e paraqitura, evidentohet se ndaj të 3 vendimeve është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe për njërin prej tyre edhe rekurs në Gjykatën e Lartë, ku gjykatat më të larta kanë lënë në fuqi vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por nuk i ka përdorur rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjuhësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të dhëna prej saj plotësojnë kërkesat e legjislacionit procedural penal. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, në disa raste rezulton e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Subjekti, në arsyetimin e vendimit, fokusohet te thelbi i çështjes, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Në rastet e dënimit me burgim disponohet për fillimin dhe vendin e vuajtjes së dënimit, sipas rastit disponohet edhe për provat materiale. Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave konstatohet se subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) ka pasur ngarkesë sasiore dhe e ka respektuar kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, si dhe i ka kushtuar rëndësi kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore. Dosjet penale të vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt nga 1-7 ditë nga marrja e çështjes në

short, përmes vendimeve për caktimin e seancës për gjykimin e çështjes apo kërkesës penale. Nga vëzhgimi ka rezultuar se orari i fillimit të seancave gjyqësore përgjithësisht është respektuar. Në rastet e vonesave të vogla shkaqet kanë qenë të arsyeshme dhe janë evidentuar në procesverbalin e seancave gjyqësore. Gjatë gjykimit, gjyqtarja Tereza Lani (Merkaj) zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedural penal procedurën e gjykimit të zakonshëm apo të shkurtuar gjatë drejtimit të procesit gjyqësor. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural merr rregullisht mendimin e palëve në gjykim. Ajo ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar mbrojtjen duke i caktuar avokat kryesisht apo legjitimuar mbrojtësin e zgjedhur. Në të pesta dosjet penale u konstatua se vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë nga gjyqtarja brenda afatit maksimal 10-ditor, të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe data e seancës i është njoftuar 10 ditë para datës së caktuar për gjykim, sipas përcaktimeve të nenit 333/2 të Kodit të Procedurës Penale.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Procesverbalet e seancave gjyqësore rezultojnë të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe nga gjyqtarja, konform kërkesave të nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Në dosje gjenden aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, procesverbali i seancave gjyqësore, vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, vendimet përfundimtare, fletëthirrjet e aktet e njoftimit, provat, parashtrimet e konkluzionet etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultojnë 1 ankesë për mohimin e një procesi të rregullt ligjor, shkelje të etikës dhe solemnitetit në gjykim për gjyqtaren Tereza Lani (Merkaj). Kjo ankesë e vitit 2015 ka mbetur në proces verifikimi dhe me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni, me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. *** prot., datë 28.7.2020.

Nga të dhënat e regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj). Për vetë gjyqtaren në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj

nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Tereza Lani (Merkaj) komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Tereza Lani (Merkaj) për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Evidentohet se çështjet janë gjykuar me gjyqtare të vetme subjektin e rivlerësimit, me përjashtim të dosjes nr. 5, të gjykuar me trup gjykues të përbërë me 3 gjyqtarë, ku subjekti është relatore e kryesuese e trupit gjykues. Nga vëzhgimi i dosjeve rezulton se vonesat e vogla në fillimin e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive dhe të evidentuara në procesverbalin gjyqësor dhe jo për mungesë bashkëpunimi. Gjithashtu, nuk evidentohet që të ketë pasur ndonjë dështim të seancave të planifikuara, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Edhe në lidhje me arsyetimin e vendimeve rezulton se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Tereza Lani (Merkaj) i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 7 seminare të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Gjithashtu, subjekti, gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka qenë eksperte sipas Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në temën “Probleme teorike dhe praktike lidhur me shqyrtimin e kërkesave të të dënuarve në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Jurisprudenca e GjEDNj-së”, në periudhat 6-7 maj 2010, 14-15 qershor 2010 dhe 17-18 shkurt 2011, bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 24.3.2011, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës.

C/1. RIVLERËSIMI PROFESIONAL

i. Trupi gjykues, pas njohjes me raportin e vlerësimit profesional, si dhe verifikimit të të gjithë dokumenteve ligjore të administruara dhe akteve në pesë dosjet e shortuara, sipas të cilëve është përgatitur raporti përkatës, nuk konkludoi problematika për subjektin e rivlerësimit, si lidhur me aftësitë profesionale, organizative dhe personale, ku në secilin prej tyre zbërthehen kriteret matës për të kryer rivlerësimin profesional. Njëkohësisht, trupi gjykues nuk diktoi problematika as në elementet e tjera të rëndësishme që identifikojnë rolin dhe figurën e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës dhe që ndikojnë në vlerësimin profesional ndaj tij, si etika, integriteti, paanësia, etj. Ky rivlerësim mban në konsideratë gjithashtu edhe trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të depozituara në adresë të subjektit në organin përkatës, të cilat pasqyrohen në vijim.

ii. Konkretisht, mbi ankesat e depozituara në adresë të subjektit, të cilat ishin përshkruar edhe në raportin e vlerësimit profesional, Komisioni i kërkoi Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në vijim ILD) informacion lidhur me një ankesë të vitit 2015, si dhe lidhur me ankesat e përsëritura në vitin 2016, për të cilat konfirmohej se tre prej tyre gjithashtu i ishin dërguar këtij institucioni për ndjekje. Në përgjigjen e dhënë, ILD-ja⁷⁰ ka konfirmuar se me vendimin nr. *** prot., datë 18.11.2021, ka vendosur arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara me nr. *** prot., datë 16.6.2021, nr. *** prot., datë 16.6.2021, nr. *** prot., datë 16.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 1.2.2021, të paraqitura nga shtetasit E. Z. dhe F. T. ndaj subjektit të rivlerësimit. Ndër të tjera, në vendim thuhet se çështja për të cilën këta shtetas janë ankuar është gjykuar dhe vendosur prej vitit 2016 dhe se ILD-ja nuk mund të marrë vendim për fillim hetimi disiplinor në rast se në kohën e marrjes së vendimit ka kaluar afati 5-vjeçar i parashkrimit të parashikuar nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016. Në të tilla kushte, trajtimi i ankesave është bërë ezaurues.

Në lidhje me 11 denoncimet⁷¹ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pas trajtimit dhe analizimit për ⁷² prej tyre u konkludua se pretendimet e denoncuesve nuk përbënin fakte apo rrethana të cilat mund të ndikonin në vlerësimin profesional të subjektit, ndërsa Komisioni u ndal tek 2 denoncime të shtjelluara në vijim, për të cilat i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin provues. Më konkretisht:

1. Në lidhje me denoncimin⁷³ e shtetasit K. H., Komisioni hetoi dhe konstatoi si vijon:

Sa i përket përmbajtjes së denoncimit, rezultoi se ky shtetas ankohet ndaj një kërkese penale të vënë në lëvizje nga organi i akuzës ndaj tij, nën akuzën “kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal, e cila, po sipas thënieve të tij, është në proces gjyqësor⁷⁴ duke u gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi ankohet se nuk janë respektuar dispozitat ligjore lidhur me caktimin e seancës paraprake, njoftimin e palës (të paktën 10 ditë përpara për të pasur një mbrojtje efektive) për t’u njohur me aktet, për të depozituar memorie apo dokumente, etj., dhe nën këto pretendime ka specifikuar konkretisht se shkeljet e kryera tregojnë mosrespektimin e pikave 3, 49, të nenit 332/a, të Kodit të Procedurës Penale. Denoncuesi pretendon gjithashtu se nuk i janë vënë në dispozicion kopje të akteve të dosjes gjyqësore dhe nën këto pretendime hedh dyshime se nuk do të ketë një proces të rregullt ligjor dhe të paanshëm, siç e kërkon legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar i ratifikuar.

1.1 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime⁷⁵ mbi pretendimet e denoncuesit lidhur me këtë çështje.

1.2 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar:

- Për këtë procedim penal në ngarkim të këtij shtetasi është disponuar paraprakisht me vendim për kthimin e saj organit të akuzës me një afat kohor të caktuar për t’u kryer të tjera hetime dhe më pas, pas kryerjes së tyre, edhe dërgimit të çështjes në seancë paraprake kam pranuar kërkesën dhe kam kaluar çështjen për gjykim gjyqtarit kompetent/dhomës penale.

⁷⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2021.

⁷¹Ku dy prej denoncuesve, përkatësisht shtetasit M.A. (ka paraqitur denoncim nr. *** prot., datë 13.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 18.12.2017) dhe shtetasja E.C. (ka paraqitur denoncim nr. *** prot., datë 7.10.2019 dhe nr. *** prot., datë 23.10.2019), kanë depozituar denoncimin e tyre në mënyrë të përsëritur.

⁷²Denoncimet: nr. *** prot., datë 13.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 18.12.2017; nr. *** prot., datë 15.2.2018; nr. *** prot., datë 14.8.2018; nr. *** prot., datë 30.4.2019; nr. *** prot., datë 7.10.2019 dhe nr. *** prot., datë 23.10.2019; nr. *** prot., datë 11.9.2019; nr.***prot., datë 9.10.2019, denoncim ky i ardhur nga Kolegji me nr. *** prot., datë 8.10.2019.

⁷³Denoncimi nr. *** prot., datë 22.5.2018.

⁷⁴ referuar kohës kur është depozituar denoncimi, periudhë në të cilën subjekti ushtronte detyrën

⁷⁵Nëse aktualisht ka përfunduar procesi

- Subjekti sqaron se vendimi është i mirarsyetuar dhe se janë kryer të gjithë veprimet, sikurse parashohin nenet 332 dhe 333 të Kodit të Procedurës Penale, ku janë disiplinuar detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake.

- Subjekti ka depozituar: (i) vendimin gjyqësor për dërgimin për gjykim të procedimit penal ndaj këtij shtetasi; (ii) vendimin e gjykimit të themelit nr. ***, datë 8.10.2018, me të cilin denoncuesi është deklaruar fajtor për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore; si dhe (iii) vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pasqyrohet fakti se çështja e themelit është në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë.

1.3 Në analizë të pretendimeve të denoncuesit, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues konkludon se për arsyet e renditura në vijim nuk vërehen shkelje ligjore dhe as nuk diktohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit. Më konkretisht u vërejt se:

- i. subjekti në këtë çështje ka qenë gjyqtar i seancës paraprake;
- ii. nga vendimi i arsyetuar nga subjekti shihet se denoncuesi, me cilësinë e të pandehurit në këtë proces, ka qenë në mungesë të vullnetshme në seancë paraprake, çka nënkupton se nuk qëndrojnë pretendimet e tij për mosnjohje të seancës apo mosnjohjen me provat e përcjella nga organi i akuzës;
- iii. denoncuesi ka qenë i mbrojtur në këtë proces nga avokate e zgjedhur prej tij;
- iv. në vendim është pasqyruar fakti se avokatja ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së organit të akuzës dhe pushimin e çështjes së dërguar për gjykim dhe se nuk duket të jenë reflektuar prej saj, kërkesa apo pavlefshmëri të akteve deri në këtë fazë. Në vendim është arsyetuar e gjithë procedura e ndjekur, si çështja e kompetencës, verifikimi i elementëve formalë të kërkuar nga ligji procedural për shqyrtimin e kërkesës, fakti që në seancën paraprake nuk është parashtruar asnjë pretendim në lidhje me pavlefshmëri të akteve apo papërdorshmëri të provave, etj.;
- v. më parë këtij shqyrtimi në seancë paraprake (sikurse citohet në vendimin e subjektit) ka qenë vendosur kthimi i çështjes, duke i dhënë mundësinë të pandehurit të vijojë me pretendimet e tij; dhe së fundi,
- vi. çështja gjyqësore është në proces.

2. Në lidhje me denoncimin e shtetasit⁷⁶ Q. L., Komisioni hetoi dhe konstatoi si vijon:

2.1 Sa i përket përmbajtjes së denoncimit, rezultoi se shtetasi L., në ankimin e tij, ndër të tjera, ankohet për subjektin e rivlerësimit për kohën që ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (2007 – 2013), duke pretenduar se: (i) nuk pasqyronte në mënyrë të plotë dispozitivin e një vendimi në sistemin elektronik të gjykatës; (ii) është kapur me shkelje por procedurat mbylleshin për shkak të detyrës funksionale të bashkëshortit dhe vëllait të saj në institucione ligjzbatuese; dhe (iii) janë kryer shkelje në disa vendimmarrje civile dhe penale.

2.2 Lidhur me çështjet civile dhe penale të bëra prezent duke pasqyruar edhe pretendimet për secilin rast, Komisioni ka vërejtur se denoncuesi nuk ka depozituar asnjë provë bashkëlidhur ankimit të tij, se asnjëra prej çështjeve të datuara prej vitit 2007, të parashtruara prej tij, nuk impaktojnë drejtpërdrejt denoncuesin në cenimin e një procesi gjyqësor ndaj tij apo familjarëve të tij, por administrohet në kuadër të denoncimeve të publikut sikurse parasheh neni 53 i ligjit nr. 84/2016. Nga mënyra e prezantimit të rasteve vërehet se për secilën çështje të pretenduar denoncuesi ka cituar thjesht dhe vetëm të dhëna të dosjes dhe në vijim ka ezauruar në mënyrë të kopjuar sikur të jenë kryer për çdo rast të njëjtat shkelje nga subjekti. Në shumicën e çështjeve, pretendimi i denoncuesit është i njëjtë. Më konkretisht, duket se vihet theksi në gjykimin e themelit të çështjeve, duke shprehur dhe sqaruar mënyrën se si ka arsyetuar subjekti

⁷⁶Denoncimi nr. *** prot., datë 7.5.2021.

vendimet, se si ka konsideruar provat dhe faktet përgjatë gjykimit apo se si është shprehur në përfundim të gjykimit, krahasuar me kërkimin e palëve.

2.3 Në vijim, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimin e denoncuesit në çështjet e renditura prej tij, në pikën 3 (citohet çështja penale me të pandehur P.Xh.), pikën 9 (citohet çështja penale me të dënuar L.C.), pikën 10 (citohet çështja penale me të pandehur L.K.-T.) dhe pika 19 (citohet çështja civile me kërkuese shtetasen K. N.), si dhe të depozitojë dokumentacion mbështetës mbi shpjegimet e saj. Gjithashtu i kërkoi subjektit të depozitojë dokumentacion lidhur me statusin aktual të të gjithë çështjeve që përmend denoncuesi në ankimin e tij.

2.4 Subjekti, në prapësimet e saj, ka sqaruar se personalisht nuk e njeh dhe me sa mban mend as nuk ka pasur ndonjë proces gjyqësor me këtë shtetas, por thekson se ashtu sikundër dhe Komisioni ka konstatuar në raportin përfundimtar, ankesa e tij për një numër të konsiderueshëm prej 19 vendimesh gjyqësore të cilat janë disponuar prej saj me cilësinë e gjyqtarës së vetme apo në përbërje të trupave gjykues gjatë ushtrimit të funksionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë procese e vendime gjyqësore për të cilat nuk ka asnjë interes apo të drejtë të ligjshme të cenuar dhe, për më tepër, rezultojnë se pretendimet e tij jo vetëm janë tërësisht të pabazuara në ndonjë fakt apo provë konkrete, por, përkundrazi, vetë vendimet gjyqësore, *shprehet subjekti*, të referuara dhe trajtuara në vijim, me argumentet përkatëse e dokumentacionin shoqëruar të vënë në dispozicion, vërtetojnë më së miri të kundërtën e ankesës dhe ligjshmërinë e çdo vendimi gjyqësor të disponuar prej saj me cilësinë e gjyqtarës në gjithë vitet e ushtrimit të detyrës në këtë funksion. Për fat të keq, *shprehet subjekti, më rezultojnë se kjo ankesë ka si qëllim të vetëm cenimin e imazhit të saj profesional*.

2.5 Subjekti ka sqaruar gjithashtu se për të gjitha vendimet e listuara të dhëna prej saj në cilësinë e gjyqtarës së vetme apo dhe në përbërje të trupit gjykues, ashtu si dhe për të gjithë vendimet e tjera që ka dhënë gjatë ushtrimit të detyrës ndër vite, ka zbatuar me përpikëri dispozitat ligjore materiale dhe ato procedurale që disiplinohen gjykimin, duke zhvilluar për çdo rast një proces të rregullt ligjor në të gjithë parametrat e tij, si nga pikëpamja formale, ashtu edhe ajo substanciale, brenda afateve optimale të gjykimit. *Për gjithë vitet e karrieres në sistemin gjyqësor thuhet nuk kam pasur ankesa nga vetë palët, ndërkohë që të gjitha vendimet e referuara në këtë ankesë nga një person i vetëm, shtetasi Q.L., i cili nuk ka zhvilluar asnjë gjykim me mua, janë vendime të formës se prerë, për të cilat mjafton vetëm një shikim qoftë edhe sipërfaqësor i tyre për të parë e konsideruar aftësitë dhe cilësitë e mia në ushtrimin e detyrës së magjistratit në drejtim të hartimit, formës, analizës, përmbajtjes, por edhe bazueshmërisë ligjore të tyre”*.

2.6 Subjekti ka depozituar kopje të të gjitha vendimeve gjyqësore⁷⁷.

2.7 Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me çështjet konkrete, për të cilat iu kërkua të japë shpjegime.

2.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, arsyeton në tërësi çështjet e pasqyruara në këtë denoncim dhe në veçanti çështjet për të cilat i janë kërkuar shpjegime, si vijon:

a. Sa i përket pretendimit të denoncuesit se subjekti *nuk pasqyrore në mënyrë të plotë dispozitivin e një vendimi në sistemin elektronik të gjykatës*, trupi gjykues çmon se kjo praktikë

⁷⁷Vendimet: nr. ***, datë 11.12.2007; nr. ***, datë 20.9.2007; nr. ***, datë 10.7.2007; nr. ***, datë 10.7.2007; nr. ***, datë 28.5.2007; nr. ***, datë 5. 2.2007; nr. ***, datë 10.4.2007; nr. ***, datë 2.12.2009; nr. ***, datë 16.5.2011; nr.**, datë 7.11.2011; nr. ***, datë 15.11.2011; nr. ***, datë 14.6.2011; nr. ***, datë 23.1.2012; nr. ***, datë 12.7.2011; nr. ***, datë 14.6.2011; nr. ***, datë 21.11.2011; nr. ***, datë 2.1.2008; dhe nr.**, datë 13.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; si dhe vendimet nr.**, datë 27.7.2016 dhe nr. ***, datë 7.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

nuk është kompetencë e subjektit, por e sekretarisë gjyqësore dhe, për pasojë, nuk vërehen shkaqe apo rrethana të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

b. Sa i përket pretendimit tjetër të denoncuesit se *subjekti është kapur me shkelje por procedurat mbylleshin për shkak të detyrës funksionale të familjarëve të saj në institucione ligjzbatuese*, trupi gjykues vlerëson se pretendimi nuk qëndron, për sa kohë organi ligjzbatues (DSIK) ka dërguar një raport të plotë, të deklasifikuar plotësisht, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga ky subjekt, por njëkohësisht edhe nga hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me përditësimin e raportit të DSIK-së, kjo e fundit ka rikonfirmuar konstatimin fillestar për përshtatshmërinë në ushtrimin e detyrës së saj.

c. Sa i përket pretendimit tjetër të denoncuesit se *nga subjekti janë kryer shkelje në disa vendimmarrje civile dhe penale*, fillimisht është vënë re se kryesisht pretendimet i përkasin gjykimit të themelit, duke u pretenduar thujse në shumicën e rasteve me të njëjtin citat se subjekti në arsyetim të vendimeve nuk arsyeton provat dhe faktet.

ç. Në lidhje me çështjen penale në ngarkim të shtetasit P.Xh., për të cilin denoncuesi pretendon se subjekti në këtë çështje penale me këtë të pandehur ka dhënë dënim qesharak, subjekti ka sqaruar se:

- *Kjo ankesë është tërësisht e pabazuar.*
- *Vendimi nr. ***, datë 7.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është një vendim penal themeli me kryesues gjyqtarin A. A. dhe subjekti është në cilësinë e anëtares.*
- *Përgjegjësia penale, llojet dhe masat e dënimit penal dhe çdo element tjetër lidhur me ekzekutimin e dënimit të caktuar secilit prej të pandehurve janë arsyetuar në vendim në përmbajtjen e tij bazuar në dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe mund të verifikohet lehtësisht.*
- *Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 21.3.2017, për të pandehurin P. Xh. dhe të pandehurit e tjerë, duke u ndryshuar pjesërisht dhe duke lehtësuar dënimin kjo gjykatë për një prej të pandehurve.*
- *Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 7.7.2016.*

i. Trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit gjyqësor të administruar, vërejtë se sipas këtij vendimi ndër 8 të pandehur në këtë cilësi ka qenë edhe shtetasi P. Xh. . Çështja, objekt gjykimi, i referohet problematikave të shfaqura nga kontrolli i ushtruar në disa farmaci, ku kanë rezultuar receta të pavulosura apo medikamente të pa marra nga pacientët, etj.

ii. Çështja është vënë në lëvizje nga organi i akuzës dhe ky shtetas është akuzuar për shpërdorim detyre.

iii. Organi i akuzës për këtë shtetas ka kërkuar dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj heqje lirie, si dhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për 3 vjet.

iv. Gjykata ka vendosur këtë dënim dhe më tej ka aplikuar edhe zbatimin e nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 59 të Kodit Penal, duke pezulluar dënimin dhe lejuar të pandehurin të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës për 2 vite e 6 muaj, si dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të funksionit për 3 vjet.

v. Vendimi ka mbetur në fuqi në Gjykatën e Apelit, Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.3.2017, me një ndryshim, duke lehtësuar pozitën e njëres prej të pandehurve.

vi. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit lidhur me këtë vendimmarrje.

d. Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin L. C., ish-administrator i firmave piramidale, denoncuesi ka pretenduar se ky shtetas është liruar me kusht, në kundërshtim me kërkesat e nenit 64 të Kodit Penal.

Subjekti, në shpjegimet e saj, ka sqaruar se:

- *Kjo ankesë është tërësisht e pabazuar.*
- *Me vendimin nr. ***, datë 2.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pas një shqyrtimi të plotë e kompleks gjyqësor të kërkesës penale, pasi kam verifikuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar çdo kriter ligjor për zbatimin e këtij instituti të së drejtës penale, kam disponuar lirimin me kusht të të dënuarit L. C., i cili kishte vuajtur fizikisht 7 vjet, 7 muaj e 3 dite burgim (3/4 e masës totale të dënimit të dhënë), duke i mbetur për të vuajtur edhe 11 muaj e 22 ditë burgim.*
- *“Lirimi me kusht” është e drejtë që Kodi Penal ia njeh çdo të dënuari me burgim që plotëson kërkesat specifike të nenit 64 të Kodit Penal dhe ndjek qëllim riintegrues në risocializimin e të dënuarit dhe këtë qëndrim e ka mbajtur edhe GjEDNj-ja në një sërë vendimesh të saj, ku ka theksuar vlerën dhe rëndësinë që merr zbatimi i këtij instituti tek të dënuarit me burgim.*
- *Gjykata ka zhvilluar një hetim të thellë gjyqësor.*
- *Kam kërkuar informacion dhe administruar dokumentacion jo vetëm nga kërkuesi, por edhe nga IEVP-ja Peqin, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Provës. Çdo element i këtij vendimi, pretendimet e palëve, provat e administruara, arsyetimi, bazueshmëria ligjore dhe disponimi gjyqësor mund të verifikohen lehtësisht nga ju duke ju vënë kopje të këtij vendimi në dispozicion.*
- *Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe po ashtu është disponuar me mospranim rekursi nga Gjykata e Lartë.*

i. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe nga verifikimi i vendimit gjyqësor, së pari vëren se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar këtë çështje si gjyqtar i vetëm. Nga vendimi konstatohet se janë referuar dhe arsyetuar të gjithë kërkesat e nenit 64 të Kodit Penal. Ky shtetas është dënuar me 10 vjet burgim në vitin 2003 për veprën penale “mashtrim” për firmat piramidale. Në vendim arsyetohet mbi bazë të provave të administruara dhe duket se provat i janë nënshtruar debatit gjyqësor.

ii. Gjithashtu, vërehet se edhe ky vendim i dhënë i është kushtëzuar të dënuarit C., që për një periudhë 18-mujore të mos kryejë vepër tjetër penale me dashje.

iii. Vendimi është ankimuar nga organi i akuzës dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e nr. ***, datë 2.2.2012, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë dhe po kështu kjo çështje ka përfunduar edhe në Gjykatën e Lartë.

iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit lidhur me këtë vendimmarrje.

dh. Lidhur me çështjen penale me të pandehur shtetasin L.K.(T.), në këtë çështje denoncuesi ka pretenduar se ky shtetas ka qenë i dënuar më parë dhe subjekti ka vendosur masën “arrest në shtëpi”, e cila më tej është zëvendësuar me “arrest në burg”. Ai pretendon se në vendim ka mangësi e dobësi në analizë dhe se nuk arsyetohet kuptueshëm.

Mbi këto pretendime, subjekti ka shpjeguar:

- *Pretendohet se kam caktuar masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” ndaj shtetasit L. K.(T.), dyshuar për kryerje të veprës penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, pa arsyetuar provat dhe arsytet për këtë disponim.*
- *Edhe këtë ankesë e konsideroj tërësisht të pabazuar.*
- *Me vendimin nr. *** datë 2.1.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” ndaj këtij shtetasi, në pajtim të plotë me dispozitat procedurale-penale që disiplinojnë caktimin e masës së sigurimit personal.*
- *Për këtë rast (që në pjesën hyrëse të vendimit), rezulton se seanca gjyqësore është mbajtur nga ana ime me palët dhe sekretaren gjyqësore në ambientet e Spitalit të Kirurgjisë*

Elbasan për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të personit nën hetim, i cili rezultoi të ishte invalid i grupit të parë me statusin paraplegjik-tetraplegjik, lëvizte vetëm me karrocë invalidi dhe me nevojë të përhershme për një kujdestar (sipas akteve provuese të administruara në gjykim) që ta ndihmonte në kryerjen e nevojave personale, gjë e cila nuk mund të realizohej në kushtet e paraburgimit, duke bërë të pamundur kushtet minimale të jetesës së tij.

- *Gjykatës nuk iu paraqit në seancë (e cila ka afat për t'u mbajtur 48 orë për shkak të kufizimit të lirisë së personit) asnjë dëshmi penaliteti, vendim dënimi penal apo qoftë edhe ndonjë vendim caktim mase sigurimi, që të provonte faktin e qenies me precedent të të arrestuarit apo procedimit të tij penal për vepra të tjera penale.*
- *Në mungesë të provave apo indicieve për këtë fakt, gjykata nuk mund të hipotezojë/hamendësojë për gjendjen gjyqësore të tij si i dënuar më parë pa një akt provues sepse cenon parimin e prezumimit të pafajësisë së të arrestuarit dhe në thelb cenon vetë procesin e rregullt ligjor.*
- *Janë argumentuar e analizuar plotësisht provat dhe kërkesat ligjore në caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” ndaj këtij shtetasi të pasqyruara në përmbajtje të vendimit gjyqësor.*
- *Është e vërtetë që ky vendim gjyqësor është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, por kjo e fundit ka administruar prova shtesë në gjykimin në apel dhe ky fakt nuk ndikon në vlerësimin dhe vendimmarrjen e gjykatës së faktit.*
- *Subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor.*

i. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të denoncuesit, shpjegimeve të subjektit dhe verifikimit të vendimit gjyqësor, i cili gjithashtu është voluminoz, konstatoi se:

ii. Organi i akuzës ka kërkuar masën e sigurimit personal “arrest në burg” për këtë të dyshuar për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” (çështje e vitit 2008), “kanosje” dhe “prishje e qetësisë publike”.

iii. Në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor citohet fakti se gjykata ka caktuar këtë masë në ambientet e spitalit.

iv. Në vendim janë renditur provat e administruara përfshirë edhe epikrizën dhe librezën e invaliditetit.

v. Caktimi i masës është i një natyre të veçantë dhe në kushte të dhënies brenda afatit të kushtëzuar 48 orë, çka të lejon të vendosësh mbi ato akte dhe pretendime të organit të akuzës dhe të dyshuarit apo mbrojtësit.

vi. Ndryshimi i masës nga gjykata e apelit vjen si pasojë e ndryshimit të rrethanës lidhur me faktin se i pandehuri ka qenë i dënuar më parë. Gjykimi në këtë shkallë ka pasur mundësinë e administrimit të provave të siguruaras pas 48 orëve dhe që për pasojë ka arritur në një tjetër konkluzion.

vii. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit lidhur me këtë vendimmarrje.

e. Në lidhje me çështjen civile me kërkuese K. N., me objekt “heqje zotësie për të vepruar dhe caktim kujdestari”, të denoncuar për mospjesëmarrje në gjykim të një anëtari të trupës gjykuese me gjithë nënshkrimin e pasqyruar në vendim, denoncuesja pretendon se në vendimin nr***, të datës 13.11.2007, një anëtare e trupës nuk ka marrë pjesë në seancën gjyqësore, por ndërkohë rezultoi që ajo të ketë nënshkruar vendimin.

Subjekti, në shpjegimet e saj, ka sqaruar:

- *Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 13.11.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkuese K. N., me objekt “heqje zotësie për të vepruar e caktim kujdestari”, është*

kërkesë pa palë kundërshtare, sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk është kontestuar nga palët pjesëmarrëse në të dhe as është bërë objekt ankimi, sepse çështja/gjykimi është pushuar mbi kërkesën me shkrim për heqje dorë nga pala kërkuese dhe mbrojtësi i saj.

- *Vendimi i dhënë, në kuptim të nenit 127 të Kodit të Procedurës Civile, është “një vendim jo përfundimtar” që nuk e ka zgjidhur çështjen në themel, nuk ka sjellë pasojën juridike të pritshme dhe dëshiruar sipas natyrës së këtij lloj gjykimi.*
- *Vendimi nuk ka cenuar asnjë të drejtë të ligjshme të palës kërkuese (e cila me vullnetin e saj ka hequr dorë).*
- *Vendimi nuk ka ndikuar në dhënien e drejtësisë, por vetëm i ka dhënë fund një procesi gjyqësor të iniciuar.*
- *Në përbërjen e trupit gjykues prej tre gjyqtarësh, ditën e dhënies së vendimit jo përfundimtar, është kryer me urdhër verbal të Kryetarit të Gjykatës në atë periudhë zëvendësimi i anëtares në mungesë me një tjetër gjyqtar dhe kanë qenë pasaktësitë dhe veprimet e shkujesura për shkak të ngarkesës së punës e gjykimeve të njëpasnjëshme e të shumta, nga ana e sekretares gjyqësore që mbante procesverbalin gjyqësor të seancave (me shkrim dore) në pasqyrimin e këtyre ndryshimeve që kanë shkaktuar parregullsitë e konstatuara në vijim në procesverbal dhe mandej në vendimin përkatës.*
- *Shpjegimet e detajuara janë dhënë nga ana ime në observacionet përkatëse drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së, duke u hetuar rasti në fjalë dhe duke u arkivuar praktika përmbledhëse si nga Ministria e Drejtësisë, ashtu dhe nga KLD-ja për shkak të moskonstatimit të asnjë shkeljeje ligjore (tashmë dhe e parashkruar për shkak të kalimit të afateve kohore).*
- *Kjo çështje është kallëzuar edhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kjo e fundit, me vendimin e datës 17.7.2010, pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, ka disponuar për “mosfillimin e hetimeve” për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2010.*
- *Subjekti ka depozituar vendimin e pushimit, si dhe vendimin e organit të akuzës mbi mosfillimin e hetimeve.*

i. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të administruar, konstatoi se çështja objekt i këtij hetimi i përket vitit 2007. Gjithashtu, u konstatua se:

ii. Vendimi i pushimit për shkak të objektit të padisë “heqje e zotësisë për të vepruar dhe caktim kujdestarie” është ndërmarrë nga 3 gjyqtarë.

iii. Vendimi nuk ka zgjidhur themelin e çështjes.

iv. Sqarimi i subjektit se ka pasur një gabim njerëzor nga sekretarja në procesverbal, duket i pranueshëm.

v. Fakti që vendimi nuk ka sjellë pasojë duket të ketë zbehur interesimin për t’u korrigjuar sepse mund të kishte ndodhur një gabim njerëzor në një vendim themeli dhe në kohë do të duhej të ishte korrigjuar.

vi. Gjithnjë, parë nën kontekstin e një vendimi të pushimit të çështjes, e vënë në lëvizje me kërkesë, i paankimuar, apo pa kontestime nga pala kërkuese, duket pranues sqarimi i subjektit se gabimisht në vendimin gjyqësor të pushimit është cilësuar përsëri e njëjta gjyqtare (për shkak se si fillim çështja do të ketë nisur me të), ndërsa ajo ishte zëvendësuar nga drejtuesi në mënyrë verbale.

vii. Në këtë konkluzion ka arritur edhe organi i akuzës në vendimin e mosfillimit të hetimeve.

viii. Pretendimi i denoncuesit, duket një çështje e ezauruar edhe me vendim të organit të akuzës dhe që për pasojë në këtë nivel që ndodhen provat, duket se nuk çënohet subjekti i rivlerësimit në vlerësimin e saj profesional.

ix. Ajo që bie në sy është fakti se kallëzimi nuk është bërë nga kërkuesi në çështjen civile sepse në fund të fundit kërkuesi ka hequr dorë nga gjykimi dhe në këto kushte interesimi i tij për momentin ka qenë thjesht dhe vetëm pushimi i çështjes.

x. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi analizimin e kësaj çështjeje, megjithëse i përkiste një periudhe të largët, dhe në përfundim, duke konsideruar edhe ezaurimin e saj në organin e akuzës, çmon se nuk diktohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

➤ Në lidhje me vendimet e tjera gjyqësore, për të cilat gjithashtu denoncuesi është ankuar përsëri për dënime qesharake dhënë nga subjekti i rivlerësimit apo edhe për shkelje të natyrës procedurale

ë. Në lidhje me çështjen penale me të pandehur N. Ç. dhe shoqërinë private “****”.

i. Subjekti, lidhur me këtë çështje, ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 27.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ii. Trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit gjyqësor, vëren se ky shtetas është akuzuar për falsifikim të dokumenteve dhe për veprën penale “mashttrim”. Në këtë çështje penale janë përfshirë disa të pandehur, përfshirë këtu edhe personi juridik “****”. Organi i akuzës për këtë të pandehur ka kërkuar dënimin e tij me 3 vjet në bashkim të dy dënimeve të akuzave.

iii. Çështja është proceduar me gjykim të shkurtuar sipas kërkesës së të pandehurve.

iv. Çështja ka si kryesuese subjektin e rivlerësimit.

v. Çështja është kallëzuar nga FSDKSH-ja për detyrime ligjore të pazbatuara lidhur me shitjen e barnave nga kjo kompani dhe për mosmbajtje të rregullt të dokumentacionit, si faturat e daljes së medikamenteve që rimbursohen, faturat e hyrjes nga importi së bashku me deklaratat doganore, etj.

vi. Vendimi është voluminoz dhe duket të jetë i mirëarsyetuar sipas standardit të kërkuar në pjesën hyrëse, arsyetuese dhe dispozitivin e tij.

vii. I pandehuri është dënuar me 3 vjet burgim dhe ndërkohë ndaj tij është zbatuar neni 59 i Kodit Penal, duke u pezulluar ekzekutimi i vendimit dhe kushtëzuar veprimtaria e tij për të mbajtur kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës dhe për të mos ndryshuar vendbanimin pa pëlqimin e kësaj të fundit.

viii. Sipas vendimit Gjykatës së Apelit, Tiranë nr. ***, datë 25.9.2017, të gjykatës së apelit është lehtësuar dënimi i të pandehurit në 1 vit e 6 muaj, është pushuar çështja penale për akuzën e veprës penale “mashttrim”, pasi nuk provohej që i pandehuri ta kishte kryer këtë vepër dhe është zbatuar neni 63 i Kodit Penal për të kryer punë në interes publik dhe për të mbajtur kontakte me institucionin e shërbimit të provës.

ix. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit lidhur me këtë vendimmarrje.

➤ Në lidhje me ankimin e denoncuesit mbi disa vendime, pa qartësuar pretendime, por vetëm duke pasqyruar numrin dhe datën e tyre.

f. Më konkretisht, bëhet fjalë për vendimet civile, përkatësisht nr. ***, datë 11.12.2007 (me paditës Sh. Sh.), i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të cilin pretendohet se është tejkalluar objekti i kërkimit në padi dhe po nën të njëjtin pretendim të denoncuesit citohen prej tij edhe 4 vendime po civile, përkatësisht nr. ***, datë 20.9.2007 (me paditëse L. M.); nr. ***, datë 10.7.2007 (me paditëse N.P.); nr. ***, datë 10.7.2007 (me paditëse Rr. Xh.); dhe nr. ***, datë 28.5.2007 (me paditëse N. Gj.), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke pretenduar për këto raste se nuk është zbatuar drejt neni 28 Kodit të Procedurës Civile.

i. Trupi gjykues, në analizë të vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, ka konstatuar se të gjithë vendimet janë me palë ndërgjyqëse Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan, me objekt: anulimin e vendimeve administrative të kësaj të fundit dhe detyrimin për lidhje të pensionit të pleqërisë mbi bazë vjetërsie në punë.

ii. Trupi gjykues, pas njohjes me vendimet përkatëse të depozituara nga subjekti, pa zëvendësuar logjikën e arsytimit nga subjekti, vërejt se në këto vendimmarrje nuk diktohen problematika sa i përket zgjidhjes së drejtë të çështjes, për sa kohë gjykata ka zgjidhur edhe pasojat e anulimit të vendimeve administrative, dhënë më parë nga pala e paditur (pavarësisht në një rast depozitimi të padisë pa përcaktuar plotësisht objektin, pra, përveç kërimit të anulimit të aktit administrativ edhe detyrimin e palës kundërshtare për të vepruar), pasi në të kundërt do të duhej të hapeshin padi të reja dhe, për pasojë, nuk do të kishte efektivitet në gjykimin e çështjeve. Në këtë arsyetim vlerësohet gjithashtu edhe fakti se në kohën e këtyre vendimmarrjeve këto situata kanë qenë disi të njohura derisa u arrit të standardizoheshin dhe ndërtoheshin padi të plota e të sakta. Nga ana tjetër, si një tregues i qartë i disponibilitetit të palëve për të zgjidhur çështjen në kohë dhe jo zvarritur atë, është fakti që vendimet janë të formës së prerë, pa u ankimuar.

iii. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në dispozitivin e këtyre vendimeve gjyqësore nuk janë tejkualuar kufijtë e kërimit të kërkesave apo padive, në kuptim të nenit 28 të Kodit të Procedurës Civile, përkundrazi, vendimmarrjet duket se kanë mbetur brenda ombrellës, duke zgjidhur çështjet në mënyrë shteruese brenda objektit të kërimit, pa u nevojitur të kthehen palët edhe njëherë në ngritjen e padive.

g. Në lidhje me ankimin tjetër të po këtij denoncuesi, i cili ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 5.2.2007 (me paditës shtetasin R.K.), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me pretendimin se është shkelur neni 388 i Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk është thirrur në gjykim pala e interesuar, subjekti ka depozituar vendimin përkatës.

i. Trupi gjykues, në analizë të vendimit me kërkues shtetasin K., me objekt “korrigjim i gabimit të bërë në mbiemrin në regjistrin e radhorit, etj.”, vëren se gjykata është vënë në lëvizje me kërkesë dhe për pasojë ka proceduar në atë formë duke pranuar kërkesën. Ndërkohë, në vitet për të cilën po kontestohet ky vendim, kur dhe është marrë nga gjykata, kërkesa të kësaj natyre duket se nuk kanë qenë të pakta, ndoshta për shkak të moskonsultimit të kërkuesve me legjislacionin apo me njohësit e tij, apo edhe për shkak se hera herës megjithëse vendimet ishin rezultat i kërkesës, pra pa palën që do të ekzekutonte dispozitivin e vendimit/pasojën, këto të fundit ekzekutoheshin vullnetarisht. Në këtë këndvështrim, për sa kohë ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar kuptohet që e ka gjetur zgjidhjen e plotë në ekzekutimin e tij në institucionin përkatës.

gj. Në lidhje me ankimin e denoncuesit ndaj vendimit penal në ngarkim të shtetasve P. R., H. M., E. B., H. B., Gj. Gj., K.T. dhe N. J., paraqitur nën të njëjtat pretendime se në arsytimin e vendimit ka mangësi dhe dobësi në analizën dhe argumentimin e bindshëm logjik të qëndrimit të saj ose se subjekti ka lehtësuar pozitën e të dënuarit, etj., subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore.

i. Trupi gjykues, në analizë të vendimeve gjyqësore, vëren se përgjithësisht janë analizuar dhe debatuar provat. Vendimet janë të mirarsyetuara, paraqesin palët dhe pretendimet përkatëse të tyre. Përgjithësisht duket se nuk qëndrojnë pretendimet e denoncuesit, për më tepër që vendimet ose kanë mbetur në fuqi pa u ankimuar, ose janë ligjëruar me lënien në fuqi pas ankimit të palëve apo organit të akuzës.

ii. Ndërsa, më konkretisht, në analizë të vendimit të dhënë për secilin shtetas, trupi gjykues ka konstatuar dhe konkluduar si vijon:

1. Lidhur me vendimin penal nr. ***, datë 10.4.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që i përket të pandehurit P. R., i akuzuar për veprat penale “shkelje të rregullave të qarkullimit”, “largim nga vendi i aksidentit” dhe “drejtim të automjeteve në gjendje të dehur”, sipas vendimit rezultoi se subjekti ka vendosur dënimin e këtij të pandehuri me 8 vjet burgim, me ndalimin e drejtimit të automjetit për 5 vjet dhe me pushimin e veprës penale të largimit nga vendi i aksidentit.

Ky vendim ka mbetur në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 12.8.2008, si dhe me vendimin nr. ***, datë 10.7.2009, nuk është pranuar rekursi i paraqitur nga i gjykuari P. R. .

2. Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 16.5.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur shtetasin H.M., etj., akuzuar për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe “prishje të qetësisë publike”, subjekti ka vendosur sipas kërkesës së organit të akuzës duke e dënuar këtë shtetas me 8 muaj burgim. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

3. Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur shtetasin E. B., etj., akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve të kryer në bashkëpunim”, subjekti ka vendosur një masë dënimi më të lehtë nga kërkimi i organit të akuzës nën arsyetimin (ndër të tjera) se të dy të pandehurit kanë qenë të mitur. Subjekti ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, si dhe mbajtjen e kontakteve me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, vazhdimin e arsimit, moshoqërimin me persona të dënuar, etj. Vendimi, megjithëse është ankimuar nga organi i akuzës, ka mbetur në fuqi me vendimin nr. ***, datë 13.3.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe njëkohësisht me vendimin nr. ***, datë 10.12.2015, të Gjykatës së Lartë nuk është pranuar rekursi i organit të akuzës.

4. Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 14.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur shtetasin Gj. Gj., etj., akuzuar për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” dhe “mbajtje, prodhim dhe transportim të substancave kimike” (rezultoi se subjekti ka qenë anëtare e trupës gjykuese) është vendosur sipas kërkimit të organit të akuzës, por duke u aplikuar edhe neni 406/1 Kodit të Procedurës Penale. Rezultoi se vendimi ka mbetur në fuqi pa u ankimuar.

5. Në lidhje me vendimin nr.***, datë 23.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur shtetasin K. T., akuzuar për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, subjekti i rivlerësimit ka vendosur dënimin e këtij shtetasi me 3 vjet e 4 muaj burgim, por duke aplikuar edhe nenin 59 të Kodit Penal dhe duke e kushtëzuar të dënuarin të mbajë kontakte me institucionin e shërbimit të provës, të mos drejtojë automjete për 2 vjet dhe gjatë kësaj periudhe të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Mbi ankimin e organit të akuzës, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 3.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

6. Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 12.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur shtetasin N. J., akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, subjekti i rivlerësimit, pas kërkimit të organit të akuzës për dënimin e këtij shtetasi me 6 vjet burgim, e ka dënuar me 5 vjet burgim, duke aplikuar edhe nenin 59 të Kodit Penal për pjesën e mbetur, pasi rezultonte se deri në vendimmarrje i kishin mbetur edhe 3 vjet. Njëkohësisht, vendimi i ka kushtëzuar të dënuarës kontaktet me institucionin e shërbimit të provës, disa veprime për t’u kryer prej saj vetëm pas pëlqimit të këtij institucioni, etj. Gjykata e apelit, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2013, ka lënë në fuqi dënimin me 5 vjet burgim, ndërsa ka ndryshuar vendimin sa i përket aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal. Mbi ankimin e të dënuarit, pas rivendosjes në afat, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 138, datë 16.11.2017, ka vendosur pushimin e çështjes dhe lirim të menjëhershëm të shtetasit N.J. .

Në të tilla kushte duket se konkurren vendimmarrja e subjektit, e cila, në fakt, në thelb kishte lehtësimin e pozitës së të pandehurit dhe, për pasojë, konkurren edhe arsyetimi i vendimit të saj.

h. Në lidhje me ankimin e denoncuesit ndaj vendimit penal me të pandehur shtetasin A. H., për të cilin nuk është prezantuar asnjë pretendim, subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 21.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (ku rezultoi të jenë anëtare e trupës gjyqësore).

Sipas vendimit rezultoi se ky shtetas është akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”.

Gjykata, pas kërkimit të organit të akuzës për deklarimin e këtij shtetasi fajtor dhe dënimin e tij me 3 vjet e 4 muaj burgim, ka vendosur të njëjtën masë dënimi, por duke aplikuar edhe nenin 59 të Kodit Penal dhe disa kushtëzime për mbajtje të kontakteve me shërbimin e provës.

Mbi ankimin e organit të akuzës, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 3.12.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1042, datë 26.5.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të depozituar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

i. Në lidhje me ankimin e denoncuesit ndaj vendimit penal me të pandehur shtetasin A. K., nën pretendimin se subjekti nuk duhet ta dënonte këtë të pandehur (i mitur) për “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, me gjobë, ndërsa ai nuk ishte në punë, pra sipas tij, subjekti ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 51 të Kodit Penal, paraprakisht, trupi gjyqësor ka konstatuar se kjo dispozitë qartëson se i mituri nuk duhet dënuar më shumë se gjysma e dënimit takues që parashikon ligji për veprën penale dhe nuk parashikon një fakt të tillë të pretenduar nga denoncuesi.

- Mbi këtë ankim subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 7.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

- Sipas vendimit, rezultoi se përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar dënimin e të pandehurit me gjobë në shumën 150.000 lekë dhe në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e kësaj mase me 1/3.

- Gjykata ka vendosur sipas kërkimit të organit të akuzës dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

j. Në vijim, denoncuesi ankohet për vendimin penal të dhënë ndaj të pandehurve A. M. ose (G. B.), duke pretenduar se subjekti ka shkelur procedurat e gjyqësorit, ka mbaruar afati i paraburgimit duke e nxjerrë shtetasin B. me arrest në shtëpi. Në vendim ka mangësi dhe dobësi në analizë të arsyetimit, etj.

i. Subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 14.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur këtë shtetas dhe shtetasin A. H., akuzuar për veprat penale “vrasje me paramendim”, në bashkëpunim, dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”.

ii. Sipas vendimit, subjekti është në cilësinë e anetares së trupës gjyqësore.

iii. Po sipas vendimit rezultoi se përkundër pretendimit të denoncuesit, të pandehurit janë dënuar përkatësisht me 18 vjet dhe 25 vjet burgim.

iv. Mbi ankimin e organit të akuzës (pasi edhe për të pandehurin B. organi i akuzës kishte kërkuar dënimin e tij me 25 vjet burgim) Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 12.6.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe kthimin për rigjykim me një tjetër trup gjyqësor.

v. Pas rekursit të bërë nga prokuroria, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 313, datë 21.11.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në këtë gjykatë.

vi. Trupi gjykues konstaton se deri në këtë fazë vendimmarrja e shkallës së parë nuk është cenuar.

vii. Gjithsesi, nga verifikimi i vendimit, nuk konstatohen problematika të natyrës procedurale, nuk kemi të bëjmë me një vendim “caktim masë sigurimi” apo zëvendësim, sikurse pretendohet nga denoncuesi për “arrest shtëpie”. Pra, përgjithësisht themeli i çështjes duket të jetë në gjykim dhe që, për pasojë, nuk shihen fakte apo rrethana që të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

- a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e saj, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Tereza Merkaj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta